

Analizë e Angazhimit Politik në Shqipëri



pinion poll

TRUST IN GOVERNMENT

2016



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

MIRËNJOHJE

Ky studim u mundësua nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI - National Democratic Institute) në Shqipëri përmes mbështetjes së Ndihmës Amerikane për Demokraci (NED - National Endowment for Democracy). Opinionet e shprehura në studim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e NDI, NED ose të individëve në organizatat e mësipërme.

Hulumtuesit dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dëshirojnë të falënderojnë të gjithë pjesëmarrësit e studimit si dhe intervistuesit e terrenit për kontributin e tyre dhe motivimin për t'u angazhuar në këtë studim. Për më tepër, një mirënjohje e veçantë shkon për Institutin Demokratik Amerikan në Shqipëri, Drejtorin e Shoqërisë Hansard (Hansard Society), Përgjegjësen e Kërkimit në Shoqërinë Hansard, Ruth Fox, dhe hulumtuesin Joel Blackwell për këshillat e tyre gjatë hartimit të pyetësorit të sondazhit.

Falënderojmë, gjithashtu, znj. Svetlana Logar, Drejtuesen Kërkimore nga IPSOS, për këshillat dhe sugjerimet konstruktive gjatë hartimit të metodologjisë së kampionit.



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Autorë: Dr. Veronika Duci
Dr. Elona Dhembo

E drejta e autorit © Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI) 2016. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Pjesë të këtij studimi mund të riprodhohen dhe/ose përkthehen për qëllime jo-fitimprurëse me kusht që IDM dhe NDI të citohen si burimi i materialit si dhe t'u jepen kopje të përkthimeve përkatëse.

SHKURTESA

DFK	Diskutim në Fokus Grup
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
NDI	Instituti Demokratik Amerikan
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OJF	Organizatë jo-fitimprurëse
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PNUD/UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

TABELA E PËRMBAJTJES

Mirënjohe	2
Shkurtesa	3
Parathënie	7
Përmbledhje ekzekutive	9
1. Hyrje	12
1.1 Metodologjia	13
2. Treguesit bazë	15
2.1 Njohuritë dhe interesi	15
2.1.1. Njohuritë reale	15
2.1.2. Njohuritë e perceptuara	16
2.1.3. Interesi	16
2.2. Angazhimi politik dhe pjesëmarrja në nivel vendor dhe qendror	18
2.2.1. Angazhimi politik	18
2.2.2. Pjesëmarrja politike në një nivel vendor ose kombëtar	21
2.2.3. Pjesëmarrja dhe veprimi politik	23
2.2.4. Siguria për pjesëmarrjen në votim	23
2.2.5. Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen dhe angazhimin politik	25
2.2.6. Rrugët për të përmirësuar angazhimin politik	26
2.2.7. Rritja e pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje	29
2.3. Efikasiteti dhe kënaqësia	31
3. Perceptimet për Parlamentin dhe përfaqësuesit e zgjedhur	32
3.1. Perceptimet për Parlamentin shqiptar	32
3.2. Perceptime për deputetët dhe këshilltarët vendorë	33
4. Përfundime	37
5. Referencat	39

6. Shtojca	42
A. Rishikimi i literaturës	42
B. Metodologjia e detajuar	45
C. Zonat e studimit	48
D. Pyetësoni i studimit	49

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Informacioni dhe njohuritë e pjesëmarrësve	15
Grafiku 2. Njohuritë	16
Grafiku 3. Interesi	17
Grafiku 4. Burimet e informacionit	18
Grafiku 5. Anëtarësimi në një parti politike ose OJF/shoqatë	19
Grafiku 6. Angazhimi politik është...	20
Grafiku 7. Mbështetësit e një partie politike	21
Grafiku 8. Përfshirja në nivel vendor dhe qendror	21
Grafiku 9. Ndryshime mes zonave rurale-urbane në përfshirjen në vendimmarrje	22
Grafiku 10. Siguria për të votuar në grupe të ndryshme	24
Grafiku 11. Nismat e ndërmarra përkundrejt gatishmërisë për t'u angazhuar	24
Grafiku 12. Ndryshime mes nivelit vendor e qendror në nismat e ndërmarra	25
Grafiku 13. Arsyet për t'u angazhuar	26
Grafiku 14. Aktivitete për të kontribuar në ndryshimin e situatës	28
Grafiku 15. Përmirësimi i pjesëmarrjes në votime	29
Grafiku 16. Sa të kënaqur jeni me punën e...	30
Grafiku 17. Perceptimi i ndikimit në nivel vendor dhe qendror	31
Grafiku 18. Perceptimi për funksionet dhe përbërjen e parlamentit shqiptar	33
Grafiku 19. Deputetët dhe interesat e pjesëmarrësve	34
Grafiku 20. Cilësi të rëndësishme të një deputeti	35
Grafiku 21. Kushte për të rritur llogaridhënien e deputetëve e këshilltarëve vendorë	36
Grafiku 22. Zona e pjesëmarrësve	47
Grafiku 23. Gjinia	47
Grafiku 24. Grupet moshore të pjesëmarrësve	48
Grafiku 25. Niveli arsimor	48
Grafiku 26. Statusi i punësimit	48

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Anëtarësimi në një parti politike përkundrejt anëtarësimit në OJF/shoqatë: ndryshimet demografike	19
Tabela 2. Kampioni i studimit	46
Tabela 3. Kampioni i pjesës cilësore	46
Tabela 4. Zonat ku është kryer studimi	48

PARATHËNIE

“Analiza e Angazhimit Politik” është një studim bazë që realizohet për herë të parë në Shqipëri, i modeluar nga seritë e raporteve të Analizës Politike të Shoqërisë Hansard në Britaninë e Madhe. Ky studim u realizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e Institutit Demokratik Amerikan (NDI). Studimi mat “pulsin e angazhimit politik” të pjesëmarrësve në studim dhe ofron një bazë të dhënash unike në Shqipëri në lidhje me politikën dhe angazhimin e qytetarëve në procese politike. Këto gjetje bazohen në nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në procese demokratike si një tregues për shëndetin e një shoqërie.

Studimi synon të eksplorojë qëndrimet publike ndaj një sërë treguesish të angazhimit politik që evidentojnë njohuritë dhe interesin e pjesëmarrësve për sistemin politik; nivelin e veprimit publik dhe të pjesëmarrjes në procese politike; kuptimin e efikasitetit dhe kënaqësisë nga institucionet dhe proceset politike. Studimi ofron një panoramë të perceptimeve të pjesëmarrësve dhe angazhimit të tyre në politikë dhe proceset politike në një periudhë kohore të caktuar. Një sërë pyetjesh bazë u hartuan duke na mundësuar të kuptojmë përgjigjet e pjesëmarrësve për treguesit përkatës. Këta tregues, sikundër shpjegohet dhe në Analizën e Angazhimit Politik 12 të Shoqërisë Hansard, janë:

“fusha ndërlidhëse tejet të rëndësishme, ose ‘themelet’ e angazhimit politik. Duke marrë parasysh natyrën shumë-dimensionale të angazhimit politik

kemi zgjedhur disa tregues, të cilët nuk janë shterues. Nga ana tjetër, na ndihmojnë të kuptojmë sjelljen e publikut, njohuritë, opinionet, qëndrimet dhe vlerat e politikës dhe proceseve politike për të kuptuar më mirë forcat drejtuese të angazhimit politik dhe marrëdhëniet mes tyre”¹

Përveç treguesve bazë të angazhimit politik të grupuar rreth kategorive të njohurive dhe interesit, pjesëmarrjes dhe efikasitetit si dhe të kënaqësisë, ky studim ka edhe një seksion shtesë që lidhet me perceptimet për Parlamentin dhe përfaqësuesit e zgjedhur, duke qenë se një organ ligjvënës efikas dhe i aftë përbën themelin e qeverisjes demokratike. Në studim analizohen dallimet në angazhimin politik në bazë të faktorëve të ndryshëm demografikë. Në këtë studim paraqiten dhe krahasohen nivelet e angazhimit të pjesëmarrësve në bazë dallimeve gjinore, zonave rurale ose urbane, të moshave të ndryshme, nivelit arsimor dhe statusit të punësimit.

Kapitulli i parë ofron një panoramë të përgjithshme për të gjithë studimin dhe paraqet qëllimin dhe objektivat e tij. Në këtë kapitull përshkruhen shkurtimisht metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave.

Kapitulli i dytë i referohet rezultateve për

1. Hansard Society (2015). Audit of Political Engagement 12: Raporti i vitit 2015. London, UK: Ruth Fox dhe Joel Blackwell; fq 10. Shih: <http://www.auditofpoliticalengagement.org/assets/media/reports/Audit-of-Political-Engagement-12-2015.pdf>, e aksesuar në 14 prill 2016

treguesit kyç të angazhimit politik, domethënë njohurive dhe interesit, veprimet politik dhe pjesëmarrjes si dhe efikasitetit dhe kënaqësisë.

Seksioni i parë i këtij kapitulli përqendrohet në njohuritë dhe interesin e pjesëmarrësve, duke u përqendruar te njohuritë reale, ato të perceptuara si dhe interesin për politikën, qeverisjen vendore dhe qendrore, parlamentin, deputetët dhe presidentin. Nivelet e njohurive dhe të interesit të publikut eksplorohehen për shkak të rëndësisë që ata kanë për angazhimin politik dhe të korrelacionit të fortë mes familjarizimit dhe favorizimit. Sa më shumë njerëzit dinë rreth një institucioni, shërbimi ose procesi aq më shumë pozitivë priren të jenë ndaj tyre dhe aq më shumë të gatshëm ka gjasa të marrin pjesë dhe për t'u përfshirë në proceset përkatëse.

Seksioni i dytë trajton angazhimin politik dhe pjesëmarrjen në nivel qendror dhe vendor. Angazhimi politik mund të matet në lidhje me atë çfarë mendojnë njerëzit por edhe me veprimet që ata ndërmarrin. Për rrjedhojë, studimi vlerëson nivelet e veprimit publik dhe pjesëmarrjes në proceset politike, duke iu referuar formave formale dhe jo-formale të angazhimit, të cilat kërkojnë më shumë kohë dhe përkushtimit. Ky seksion përqendrohet në anëtarësimin në parti politike ose OJF/ shoqata dhe në mbështetjen për partitë politike. Po ashtu, ai hulumton gatishmërinë e pjesëmarrësve për t'u përfshirë në vendimmarrje në nivel vendor ose qendror, sigurinë për të votuar dhe llojet e veprimeve që pjesëmarrësit janë të gatshëm të ndërmarrin për një çështje të caktuar që i shqetëson. Përveç nivelit të gatishmërisë së mundshme, trajtohet dhe ai i nismave aktuale dhe në këtë mënyrë bëhet e mundur të kuptohet hendeku mes angazhimit aktual dhe atij të mundshëm. Në këtë seksion trajtohen edhe mundësitë për përmirësimin e angazhimit politik.

Duke u bazuar në treguesit e familjarizimit,

seksioni i tretë trajton favorizimin ndaj aspekteve të ndryshme të sistemit politik përmes pyetjeve që lidhen me efikasitetin dhe kënaqësinë. Studimi eksploron kënaqësinë e pjesëmarrësve ndaj punës së qeverisë, parlamentit dhe opozitës aktuale si dhe pushtetin që mendojnë se kanë pjesëmarrësit për të ndikuar vendimmarrjen në nivel vendor ose qendror.

Kapitulli i tretë përqendrohet në perceptimet publike për parlamentin si një institucion themelor për demokracinë tonë. Studimi i hedh një vështrim njohurive të pjesëmarrësve për parlamentin, perceptimit të tyre për rëndësinë, efektivitetin në kryerjen e funksioneve përfaqësuese dhe mbikëqyrëse dhe në angazhimin dhe trajtimin e çështjeve të rëndësishme për qytetarët. Gjithashtu, eksploron perceptimet e pjesëmarrësve për përfaqësuesit e zgjedhur, në nivel vendor dhe qendror, cilësitë e rëndësishme që duhet të kenë dhe mënyrat për të përmirësuar llogaridhënien e tyre. Për rrjedhojë, shqyrtohet marrëdhëniet mes përfaqësuesve të zgjedhur dhe qytetarëve pasi qëndron në themel të demokracisë përfaqësuese.

Në kapitullin 4 jepen përfundimet kryesore të këtij studimi bazë.

Duke marrë parasysh se në Serbi është kryer një studim i ngjashëm mbi Analizën e Angazhimit Politik që prej vitit 2013, në raport bëhen referime në pyetje të caktuara me qëllim krahasimi.

Raporti përfundon me një sërë shtojcash. Shtojca A përmban informacion teorik për angazhimin politik të sintetizuar gjatë rishikimit të literaturës së studimeve përkatëse në Shqipëri dhe më gjerë. Shtojca B përshkruan metodologjinë e përdorur për mbledhjen e të dhënave për këtë studim. Shtojca C i referohet të dhënave për shpërndarjen gjeografike të kampionit të këtij studimi. Shtojca D përmban pyetësin e përdorur në sondazh.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky është një studim bazë për Analizimin e Angazhimit Politik në Shqipëri. Duke pasur parasysh se angazhimi i qytetarëve në proceset demokratike është një tregues i shëndetit të demokracisë, studimi paraqet gjetjet nga një sondazh i kryer në 12 qarqe të vendi për një sërë treguesish për angazhimin politik, duke shërbyer si referencë për kërkime të mëtejshme e sondazhe të tjera në të ardhmen. Gjithashtu, eksploronon më shumë qëndrimet dhe perceptimet e pjesëmarrësve për parlamentin dhe përfaqësuesit e zgjedhur. Më poshtë jepet një përmbledhje e gjetjeve kryesore. Sondazhi është kryer në periudhën 8-26 shkurt 2016, ndërsa diskutimet në fokus grupe pas realizimit të sondazhit u kryen në mes të muajit mars.

Njohuritë dhe interesi

- Edhe pse pjesëmarrësit treguan se kanë njohuri të mjaftueshme për politikën në përgjithësi në Shqipëri, shpeshherë njohuritë e thelluara për institucionet dhe proceset perceptohen si të pamjaftueshme.
- Pjesëmarrësit besojnë se dinë më shumë për “politikën” dhe “qeverisjen vendore” dhe më pak për rolin e deputetëve dhe të Presidentit. Pak më shumë se gjysma e pjesëmarrësve raportojnë se dinë “pak” ose “asgjë” për qeverinë. Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve mendojnë se dinë “pak” ose “asgjë” për parlamentin. Pjesëmarrësit burra dhe ata më të mëdhenj në moshë, së bashku me ata me arsim të lartë pohojnë se dinë më shumë për këto çështje.
- Pjesëmarrësit e sondazhit shprehin interes më të lartë për qeverisjen vendore. Ata ishin thuajse njësoj të ndarë mes atyre që raportojnë se janë “shumë” ose “mjaftueshëm” të interesuar dhe atyre që “nuk janë shumë të interesuar” ose “aspak të interesuar” për politikën dhe qeverinë. Thuajse 2 nga 3 pjesëmarrësit deklarojnë se janë pak të interesuar për rolin e deputetëve dhe të presidentit. Grupmoshat e reja tregojnë më pak interes, ndërsa burrat kanë më shumë interes për të gjitha çështjet e renditura; Kryqëzimi i të dhënave për interesin dhe njohuritë e perceptuara tregojnë se shumica e pjesëmarrësve që raportojnë se dinë “shumë” ose “mjaftueshëm” kanë dhe më shumë interes për të gjitha çështjet.
- Tre burimet kryesore të informimit për politikën dhe proceset politike për pjesëmarrësit ishin: TV dhe radio (33.2%), shtypi i shkruar (20.5%) dhe miqtë dhe lidhjet e tjera (17.9%). Pjesëmarrësit nën 35 vjeç, dhe gratë nga zonat urbane preferojnë më shumë portalet online ose faqe elektronike të shtypit të shkruar si një burim informacioni, përkundrajt mediave tradicionale.

Angazhimi politik në nivel vendor dhe qendror

- Shumica e pjesëmarrësve raportojnë se nuk janë anëtarë të ndonjë partie politike (75.4%) ose OJF/shoqate (89.4%).
- Një përqindje e konsiderueshme pjesëmarrësish mendojnë se angazhimi

politik do të thotë angazhim në parti politike (44.1%); vetëm 1 nga 5 pjesëmarrësit mendojnë se një individ mund të angazhohet politikisht pa qenë pjesë e një partie politike (21.9%).

- 2 nga 3 pjesëmarrësit raportojnë se nuk janë mbështetës të asnjë partie politike.
- 1 nga 2 pjesëmarrësit do të ishin të gatshëm të përfshiheshin në vendimmarrjen në nivel vendor dhe 1 nga 3 pjesëmarrësit në nivel kombëtar.
- 1 nga 2 pjesëmarrësit raporton se do të votonte nëse zgjedhjet do të mbaheshin javën që u administrua pyetësori, 22.6% nuk do të votonin.
- Tre nismat më të shpeshta që kishin ndërmarrë pjesëmarrësit gjatë 12 muajve të fundit ishin diskutime për politikën ose për një çështje specifike me njerëz të tjerë (74.5%), kontaktimi i një këshilltari vendor ose e një zyrtari në njësinë e qeverisjes vendore (35.7%) dhe pjesëmarrja vullnetare në një aktivitet në komunitetin e tyre (32%).
- Pjesëmarrësit ishin më të gatshëm dhe me më shumë vullnet për të ndërmarrë nisma nëse ata shqetësoheshin shumë për një çështje të caktuar. Rritja në angazhimin shihet veçanërisht në mënyrat formale të pjesëmarrjes si p.sh. “pjesëmarrja aktive në një protestë ose fushatë të organizuar nga shoqëria civile” “kërkimi i informacionit nga organet shtetërore” apo “pjesëmarrja në një mbledhje të këshillit bashkiak”.
- Shumica e përpjekjeve të pjesëmarrësve ishin në nivel vendor (44.6%) krahasuar me nivelin qendror (10.7%).
- Pjesëmarrësit që raportuan se nuk kanë ndërmarrë asnjëherë asnjë nismë renditën arsytet e mëposhtme për mosveprimin e tyre: ‘asnjëri nuk na dëgjon’ (39.2%), e pasuar nga ‘politikanët mendojnë vetëm për veten e tyre’ (38.7%) dhe ‘nuk interesohen për njerëz si ne’ (22.8%).
- Shumica e pjesëmarrësve do të ishin të gatshëm të angazhoheshin në proceset politike për interesa/përfitime personale (80.9%), për të mbështetur familjen dhe miqtë (87.5%) dhe për një interes që e ndajnë me qytetarë të tjerë apo me

komunitetin e tyre (82.3%).

- Vetëm 65.9% të pjesëmarrësve u shprehën se do të ishin të gatshëm të angazhoheshin për një çështje tek e cila besojnë por që nuk lidhet me ata personalisht.
- Pjesëmarrësit deklaruan se kushtet që do të kontribuonin për të ndryshuar një situatë me të cilën nuk ishin të kënaqur janë ‘tërheqja e vëmendjes së medias për problemin’ (53.5%); ‘votimi në zgjedhje’ (50.7%); dhe ‘pjesëmarrja në aktivitete të organizuara nga qytetarët për të ushtruar presion tek vendimmarrësit’ (48.1%). Vetëm 19,9% thanë se ata do të bashkoheshin me një parti politike për të ndryshuar situatën aktuale.

Efikasiteti dhe kënaqësia

- 1 nga 2 pjesëmarrësit është i pakënaqur me punën e Parlamentit aktual (57.5%) dhe të qeverisë aktuale (56.8%). 2 nga 3 pjesëmarrës nuk janë të kënaqur me punën e opozitës aktuale (69.3%).
- Më shumë se 1 nga 2 pjesëmarrës perceptojnë se nuk kanë asnjë ndikim në vendimmarrje në zonën vendore ku jetojnë (58.7%) dhe më shumë se 2 nga 3 në vend.

Perceptime për Parlamentin dhe përfaqësuesit e zgjedhur

- Shumica e pjesëmarrësve mendojnë se Parlamenti shqiptar është thelbësor për demokracinë tonë (53.2%).
- Një numër pjesëmarrësish në sondazh nuk janë dakord me pohimet që lidhen me kryerjen e funksioneve bazë të parlamentit: vendos qeverinë para përgjegjësisë (42%), inkurajon pjesëmarrjen e publikut (45%) dhe debaton dhe merr vendime të rëndësishme për qytetarët (47.5%). 1 nga 2 pjesëmarrësit janë dakord se parlamenti është i hapur ndaj qytetarëve për të ndjekur seancat e komisioneve parlamentare dhe ato plenare (50%).
- Në lidhje me përbërjen e Parlamentit shqiptar: thuajse 2 nga 3 pjesëmarrësit nuk janë dakord se parlamenti përbehet nga përfaqësues të respektuar të shoqërisë që punojnë në mënyrë etike (65.4%) ose

që ka një përfaqësim të drejtë të të gjitha grupeve të shoqërisë (thuhet 60%). 1 nga 2 pjesëmarrësit (53%) nuk është dakord se parlamenti shqiptar është transparent në mënyrën si funksionon.

- Më shumë se 2 nga 3 pjesëmarrës (72.7%) raportojnë se ata nuk mendojnë se përfaqësuesit e zgjedhur adresojnë interesat e tyre dhe të familjeve të tyre.
- Cilësitë më të dëshiruara për një deputet janë që të jetë i ndershëm dhe i përgjegjshëm (59.7%), e pasuar nga të pasurit e një arsimimi të mirë (48.8%) dhe nga të kuptuarit se çfarë do të thotë të jesh

i/e varfër ose të jetë më afër problemeve të popullit (37%).

- Pjesëmarrësit mendojnë se ofrimi i kushteve në nivel vendor për të kontaktuar drejtpërdrejtë me deputetët ose anëtarët e këshillave bashkiakë në ditë të veçanta (përmes zyrave në deputetëve ose të bashkive) (76.2%), detyrimi për të dhënë përgjigje me shkrim ndaj kërkesave të qytetarëve në një kohë të arsyeshme (68.5%) dhe komunikimi me ta përmes Facebook (51.3%) do të rrisnin llogaridhënien e deputetëve dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë.

1. HYRJJE

Informacioni politik, pjesëmarrja në procese politike dhe besimi politik: këta janë tre komponentët e përkufizimit të “angazhimit politik” sipas Norris (2000).² Niveli dhe intensiteti i angazhimit politik dhe civil janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për shëndetin e demokracisë. Është parakusht ekzistenca e një kuadri “miqësor” institucional dhe ligjor që mundëson kanalet e angazhimit politik/civil. Nga ana tjetër, rezultatet e prekshme varen shumë nga përdorimi i tyre aktiv dhe nga besimi i publikut.

“Angazhimi politik mund të matet në lidhje me atë që mendojnë njerëzit dhe sipas asaj që ata bëjnë. Për rrjedhojë, kur studiojmë angazhimin politik, është e rëndësishme të dimë nivelet e veprimit dhe pjesëmarrjes në proceset politike, në mënyrë që të vlerësojmë llojet formale dhe jo-formale të angazhimit që kërkojnë nivele të ndryshme të përkushtimit dhe të kohës. Megjithatë, një nga dimensionet e angazhimit politik është ajo që kanë bërë njerëzit gjatë vitit të fundit, angazhimi i tyre aktual, por, nga ana tjetër, edhe nismat që ata thonë se do të ishin të gatshëm të ndërmerrnin në të ardhme, nëse ata do shqetësoheshin shumë për një çështje, mund të përbëjnë një dimension tjetër të angazhimit të mundshëm.”³

Ky studim ka përdorur tre tregues bazë,

- 2 Norris, P. (2000). *A virtuous circle: Political communications in post - industrial societies*. New York: Cambridge University Press
- 3 Hansard Society (2015). *Audit of Political Engagement 12: the 2015 Report*. London, UK: Ruth Fox and Joel Blackwell

të modeluar nga Shoqëria Hansard dhe nga “Analizimi i Angazhimit Politik”, domethënë njohuritë dhe interesat; veprimi dhe pjesëmarrja në procese politike; dhe kënaqësia dhe efikasiteti.⁴ Një seksion i shtuar në këtë studim të parë, sikundër ndodh dhe në studimet Hansard herë pas here, është ai i perceptimeve të pjesëmarrësve për Parlamentin dhe përfaqësuesit e zgjedhur si dhe dëshira e tyre për t’u përfshirë në nivel vendor dhe qendror. Këto studime, që realizohen në Britaninë e Madhe, ofrojnë një tërësi treguesish më të plotë që trajtojnë aspekte të ndryshme të angazhimit politik. Në raportet e tyre vjetore (nga 2014 deri në 2016) pohohet se treguesit e angazhimit politik janë fusha të ndërthurura, që përbëjnë aspekte të rëndësishme ose gurë themeli të angazhimit politik. Duke marrë parasysh natyrën shumë-dimensionale të fenomenit këta tregues nuk janë shterues. Megjithatë, duke trajtuar aspekte të sjelljes së publikut, njohuritë e tij, opinionet, qëndrimet dhe vlerat ndaj politikës dhe proceseve politike, ato ndihmojnë të kuptojmë faktorët e angazhimit politik dhe marrëdhëniet mes tyre.⁵

Përpjekjet për të krijuar një panoramë të qartë dhe për të sjellë evidence për angazhimin politik në Shqipëri janë të shumta. Megjithatë, pak nga ato trajtojnë tërësisht kompleksitetin e angazhimit politik dhe aspektet e ndryshme

4 Për informacion të detajuar shih faqen elektronike të Shoqërisë Hansard në: <http://www.auditofpoliticalengagement.org/reports>

5 Hansard Society (2015). *Audit of political engagement: the 12th report*. E marrë nga <http://www.auditofpoliticalengagement.org/media/reports/Audit-of-Political-Engagement-12-2015.pdf> e aksesuar në prill 2016.

të këtij fenomeni. Me qëllim që të adresojë këtë boshllëk Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim me mbështetjen e Institutit Demokratik Amerikan realizoi një sondazh në nivel kombëtar, duke u mbështetur në përvojën e Hansard Society.

Qëllimi dhe objektivat e studimit. Qëllimi i këtij studimi është të matë opinionin publik në Shqipëri në lidhje me politikën,⁶ proceset politike dhe institucionet dhe, më gjerësisht, shëndetin e demokracisë.

Duke u bazuar në këtë qëllim studimi ofron një panoramë të perceptimeve për politikës dhe proceset politike si dhe për angazhimin politik në një moment të caktuar kohor. Për më tepër, përpiqet të krijojë një bazë të dhënash si pikë reference për të matur angazhimin politik, duke u përqendruar në një sërë treguesish të modeluar nga Hansard Society nëpërmjet serisë së 'Analiza e Angazhimit Politik' (2004 - 2016), të cilët janë zgjedhur si matës kryesorë për angazhimin politik. Përfundimisht, objektivat e studimit janë:

- Të paraqesë njohuritë reale dhe të perceptuara të pjesëmarrësve si dhe interesin e tyre për politikën dhe angazhimin politik;
- Të përcaktojë pjesëmarrjen politike të pjesëmarrësve në një nivel vendor ose qendror;
- Të portretizojë perceptimet e efikasitetit dhe kënaqësisë dhe nivelin në të cilin pjesëmarrësit e studimit mendojnë se kanë ndikimin mbi vendimmarrjen;
- Të vlerësojë perceptimet e pjesëmarrësve për Parlamentin dhe për përfaqësuesit e zgjedhur; dhe së fundmi,
- Të ofrojë një platformë për diskutim mbi atë që mund të bëhet për të rritur angazhimin politik të qytetarëve në të ardhme.

1.1 Metodologjia

Raporti bazohet në një sondazh të realizuar nga IDM ku u realizuan intervista me 1538 pjesëmarrës të moshës mbi 18 vjeç. Hartimit të pyetësorit i paraprinë intervista të tjera, gjysmë të strukturuar me aktorë nga politika dhe shoqëria civile. Po ashtu, u kryen katër diskutime në fokus grup për të vleftësuar të dhënat e sondazhit dhe për të shqyrtuar më shumë çështjet më të rëndësishme. Ato u kryen me pjesëmarrës nga zona rurale dhe urbane me nivele të ndryshme arsimore, gjini të ndryshme dhe status të ndryshëm punësimi. Studimi u hartua duke u bazuar në disa tregues të ndarë në katër kategori: njohuritë dhe interesat, angazhimi politik në nivel vendor dhe qendror, efikasiteti dhe kënaqësia si dhe një kategori e shtuar për perceptimet e pjesëmarrësve për Parlamentin dhe përfaqësuesit e zgjedhur.

U përdor kampionimi me shtresa. Zonat rurale dhe urbane si dhe burrat/gratë ishin dy grupet me pjesëmarrje të barabartë në sondazh. Edhe pse sondazhi u realizua në 12 rajone të Shqipërisë, rezultatet nuk mund të përgjithësohen për të gjithë popullsinë, sepse ato përfaqësojnë vetëm mendimet e pjesëmarrësve të studimit.

⁶ Duhet të theksohet se në kontekstin shqiptar shpeshherë termi politikë përdoret për të nënkuptuar vetëm politikën e lidhur me partitë politike ose me politikanët. Megjithatë, në këtë studim termi është shpjeguar tek intervistuesit dhe është eksploruar në disa pyetje në pyetësor.

2015: Disa nga ngjarjet kryesore të vitit

JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR
<p>Në Paris në marshimin e madh të solidaritetit botëror kundër terrorizmit dhe intolerancës fetare, Shqipëria është shembulli unik i harmonisë fetare e konkretizuar me praninë e 4 krerëve shqiptarë të besimeve fetare.</p> <p>Një numër njerëzish shumë më i lartë se sa zakonisht u arrestuan këtë vit, pas fushatave të qeverisë kundër vjedhjes së dritave, kundër shkeljes së rregullave të trafikut rrugor apo kundër evazionit fiskal.</p> <p>Shqiptarët kanë nisur emigrimin masiv duke kërkuar një vend ku mund të sigurohet punësimi për të jetuar.</p>	<p>Aktivistë të shoqërisë civile e qytetare kanë protestuar pranë digës së Liqenit Artificial në Tiranë, për ndërprerjen e ndërtimit të pallatit 17-katësh në digën e liqenit.</p> <p>Parlamenti miraton ngritjen e komisionit të posaçëm të drejtësisë</p> <p>Përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë të Tiranës u mbloodhën sot në një protestë kundër ushqimeve të skaduara.</p> <p>Tryezë e rrumbullakët për autonominë vendore ku shoqatat e të zgjedhurve vendorë i janë drejtuar mazhorancës me një rezolutë të përbashkët ku i kërkojnë diskutimin dhe miratimin pa humbur kohë të strategjisë së decentralizimit dhe rishikimin e hartës, në funksion të interesave të qytetarëve dhe përmirësimit të shërbimit ndaj tyre.</p>	<p>Konferenca Ndërkombëtare "Islami dhe Paqja globale" ka mbledhur në Tiranë përfaqësues të bashkësive islame të vendeve të rajonit si dhe studiues ekspertë të ndryshëm si dhe përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore nga Shqipëria</p> <p>Banorët e Marinzës / (në Fier) kanë vijuar protestat kundër kompanisë Bankers. Në shenjë proteste, ata kanë derdhur sot para zyrave të Bankers, qumështin e prodhuar. Sipas banorëve, Bankers ka shkaktuar ndotjen e gjithë prodhimeve të tyre bujqësore dhe blegtorale.</p>	<p>Dy ditë pas dorëzimit të projekt-buxhetit për vitin 2016, shoqëria civile reagon kundër miratimit të tij pa u konsultuar më parë me ta.</p> <p>Sindikata e Arsimit i ka bërë publikisht thirrje ministrisë firmosë kontratën kolektive të punës që mbron vendin e punës së 38 mijë arsimtarëve në vend.</p> <p>Federata e sindikatave të Arsimit, ka qenë pjesërisht kundër MAS për testimin në muajin maj të mësuesve.</p>	<p>Në ditën ndërkombëtare kundër homofobisë dhe transfobisë u zhvillua nga aleanca kundër diskriminimit LGBTI një marshim paqësor me biçikleta për sensibilizimin e qytetarëve ndaj diversitetit seksual.</p> <p>Komisioni ad hoc për Reformën në Drejtësi vazhdon konsultimet me aktorët kryesorë.</p>	<p>Zgjedhjet vendore të zhvilluara u zhvilluan për herë të parë sipas ndarjes së re territoriale.</p> <p>Numri i OSHC-ve të përfshira në këto zgjedhje ishte më i madh se në zgjedhje të mëparshme.</p>
KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
<p>Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Komisionin Evropian zhvilluan një tryezë diskutimi në lidhje me Ligjin e ri të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, "Shqipëria në hapësirën evropiane të arsimit të lartë".</p> <p>Lëvizja 'Për Universitetin proteston përballë dyerve të Parlamentit kundër kalimit të Reformës për Arsimin e Lartë.</p> <p>Reforma e pensioneve dhe perceptimi i saj tek personat e interesuar ka mbledhur në një tryezë diskutimi në Durrës ekspertë të fushës, grupe interesi dhe përfaqësues të partive politike.</p>	<p>Nis kthimi masiv i azilkërkuësve nga Gjermania.</p>	<p>Protesta kundër shkurtimit të rreth 200 punonjësve nga Kompania turke "Kurum" udhëhiqet nga sindikata e punonjësve të kompanisë turke.</p> <p>Diskutimi për arsimin e lartë sot në seancën plenare ka sjellë një sërë kundërshtimesh të dhunshme nga ana e studentëve të Universiteteve të Tiranës të cilët kanë dalë në protestë para parlamentit.</p>	<p>Organizohet tryeza e rrumbullakët e shoqërisë civile dhe integrimi evropian".</p> <p>Tregtarët e Korçës dhe të Devollit. bllokuan me makina të mbushura me mollë për disa çaste hyrjen e Kuvendit për të mos lejuar deputetët të futen. Kauzës së tyre i janë bashkuar edhe deputetët e opozitës.</p> <p>Për herë të parë në historinë e futbollit shqiptar, skuadra kombëtare arriti të kualifikohet në Kampionatin Evropian të Futbollit të vitit 2016, i cili do të zhvillohet në Francë.</p>	<p>Hyrja në fuqi e ligjit për procedurat tatimore, çka dhjetëfishon gjobën për bizneset kur nuk japin kupton tatimor, ka shkaktuar protestës të tregtarëve.</p> <p>Rekord historik.</p> <p>Sipas të dhënave të publikuara nga DASH 198,625 aplikantë kanë plotësuar 100 mijë aplikime, personalisht ose si familje, për t'u zhvendosur në vendin e ëndrrave.</p> <p>Fillojnë 16 ditë aktivizimi kundër dhunës me bazë gjinore".</p>	<p>Për gati 4 orë mijëra mbështetës të opozitës, të udhëhequr nga drejtuesit e saj, protestuan kundër qeverisë sot para kryeministrit dhe tek ministria e Brendshme ku situata u përshkallëzua me djegien e bunkerit.</p>

2. TREGUESIT BAZË


2.1 Njohuritë dhe interesi

Pjesëmarrja e njerëzve në politikë dhe në procese politike varet nga qëndrimet që kanë ndaj institucioneve dhe/ose proceseve dhe njohuritë e tyre për sistemin. Për këtë arsye, studimi ka theksuar rëndësinë e matjes së interesit të pjesëmarrësve në procese politike dhe politikë dhe nivelet e njohurive reale dhe të vetë-raportuara.

2.1.1 Njohuritë reale

Njohuritë reale u vlerësuan me anë të gjashtë pyetjeve rreth politikës dhe institucioneve të ndryshme, si dhe përmes matjes së informacionit më të fundit (p.sh. kush është Ministri i Drejtësisë, i cili sa kishte ndryshuar në kohën e realizimit të pyetësorit). Shumica e pjesëmarrësve u përgjigjën saktë në pyetjet rreth njohurive për institucione të ndryshme, me përjashtim të pyetjes për numrin e bashkive (Grafiku 1).

Grafiku 1. Informacioni dhe njohuritë e pjesëmarrësve




2.1.2. Njohuritë e perceptuara

Përtej 'testimit' të njohurive reale pjesëmarrësit u ftuan të raportonin se sa besonin se dinin rreth çështjeve specifike përfshirë këtu: rolin e deputetëve, rolin e Presidentit, qeverisë, parlamentit, politikës dhe qeverisjes vendore. Për sa i përket politikës dhe qeverisjes vendore pjesëmarrësit u ndanë barabar mes atyre që raportonin se kishte "shumë" ose "mjaftueshëm" njohuri dhe atyre që kishin "pak" ose "aspak". 1 në 2 pjesëmarrës deklaronte se kishte "pak" ose "aspak" njohuri për Parlamentin. 2 nga 3 pjesëmarrës raportojnë se kanë "pak" apo "aspak" njohuri për rolin e deputetëve dhe rolin e Presidentit (Grafiku 2). Burrat, pjesëmarrësit më të moshuar dhe ata me arsim të lartë besonin se dinin më shumë krahasuar me të tjerët.

2.1.3. Interesi

Kur është fjala për interesin e pjesëmarrësve për çështje si politika, qeverisja vendore, qeveria, Parlament dhe roli i deputetëve dhe i Presidentit, thuhet gjysma e tyre raportuan se janë "shumë" ose "mjaftueshëm" të interesuar për politikën dhe qeverinë. Sërish, ndryshimi ndodh kur është fjala për rolin e deputetëve dhe të Presidentit, ku më shumë se gjysma e pjesëmarrësve thotë se janë "pak" ose "aspak" të interesuar. Ishte e pritshme që qeverisja vendore të kishte rezultatet më të larta për interesin e pjesëmarrësve (60%), gjë që tregon nevojën e ngutshme të qytetarëve për të kuptuar funksionet e saj, veçanërisht pas reformës territoriale në Shqipëri.⁷ Burrat rezultojnë të kenë më shumë interes të gjitha çështjet. Në disa raste pjesëmarrësit e zonave urbane dhe me arsim të lartë shprehin më shumë interes, veçanërisht në lidhje me rolin e deputetëve dhe atë të Presidentit. Pjesëmarrësit më të rinj në moshë tregojnë më pak interes për të gjitha çështjet (Grafiku


Grafiku 2. Njohuritë



3). Kryqëzimi i të dhënave të njohurive të perceptuara me ato të interesit të shprehur

⁷ Reforma territoriale në Shqipëri u miratua në vitin 2014.

Grafiku 3. Interesi



tregon se shumica e pjesëmarrësve që raportojnë se “dinë shumë ose mjaftueshëm” kanë gjithashtu interes më të lartë në të gjitha çështjet.

Edhe pse këto shifra konsiderohen të ulëta për Shqipërinë, kur krahasohet me Serbinë dhe me pyetjen përkatëse atje, rezultojnë se atje niveli i interesit është më i ulët.⁸ Gjatë vitit 2014, interesi i qytetarëve serbë për qeverinë ishte 23% dhe akoma më i ulët për punën dhe organizimin e Parlamentit ose të qeverisjes vendore.⁹ Në Britaninë e Madhe, sipas Analizimit të Angazhimit Politik atje për 2015, interesi për politikën ishte 50%. Studime të fundit tregojnë se publiku nuk e percepton Parlamentin si një institucion të hapur, prandaj ka edhe më pak interes për

të marrë informacione për Parlamentin.¹⁰ Të tjerë sugjerojnë se shqiptarët mendojnë se në përgjithësi institucionet publike nuk janë transparente (47%).¹¹ Gjithashtu, ka një nivel të ulët interesi për të ndjekur diskutimet parlamentare për shkak të mungesës së një kulture debati nga ana e deputetëve dhe për shkak të një zhgënjimi të përgjithshëm me politikën dhe politikanët.¹²

Tre burimet kryesore të informacionit për pjesëmarrësit kanë qenë TV dhe radio (33.2%), shtypi i shkruar (20.5%) dhe miqtë dhe lidhjet (17.9%). Sërish, mediat luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve, për rrjedhojë, duke ndikuar në qëndrimet dhe opinionet e tyre. Në Shqipëri ekzistojnë një sërë formash mediatike, ku TV dhe radio shërbejnë si burimet kryesore të informimit

8 Në Serbi Analiza i Angazhimit Politik është kryer 4 herë.

9 Otvoreni Parlament (2015). Audit of political engagement 2015: Public opinion poll on citizen participation in democratic processes in Serbia. E marrë nga <http://www.otvoreniparlament.rs/wp-content/uploads/2015/09/Audit-of-political-engagement-in-Serbia-2015.pdf> e aksesuar në prill 2016

10 National Democratic Institute (NDI) (2015). Focus Group Research Report: findings from public opinion research in Albania. Tirana, Albania

11 IDM (2015). Besimi tek qeveria. Lame dhe Papa: fq. 22

12 National Democratic Institute (NDI) (2015). Focus Group Research Report: Findings from Public Opinion Research in Albania. Tirana, Albania


për politikën. Megjithatë, shumë shpesh stacionet televizive fajësohen si të politizuara dhe të censuruara dhe që ofrojnë informacion të anshëm në mënyrë që të favorizojnë një parti të caktuar politike. Kjo është arsyeja pse besimi në media për të informuar qytetarët mund të jetë i i dëmshëm, diçka që u vërtetua dhe nga diskutimet në të gjitha fokus grupet. I njëjti shqetësim është shprehur dhe në vitin 2015 gjatë vëzhgimit të zgjedhjeve vendore, dhe evidentohet në raportin e OSBE/ODIHR¹³ në lidhje me mbulimin në media të zgjedhjeve në Shqipëri. Së fundi, pjesëmarrësit e rinj, të moshës nën 35 vjeç, gratë dhe ata që vinin nga zonat urbane preferonin më shumë portalet ose faqet elektronike të shtypit të shkruar si një burim informacioni, përkundër mediave tradicionale.

2.2. Angazhimi politik dhe pjesëmarrja në nivel vendor dhe qendror

2.2.1. Angazhimi politik

Shumica e pjesëmarrësve të sondazhit nuk ishin as anëtarë të ndonjë partie politike (75.4%) as të OJF/shoqatave (89.4%) (Grafiku 5). Pjesëmarrësit që vinin nga zonat rurale kishin më pak mundësi për të qenë anëtarë të një OJF/shoqate (33.6%) sesa ata të zonave urbane (66.4%). Megjithatë, kur ishte fjala për anëtarësimin në parti politike raporti ishte më i vogël (48% rurale përkundëjt 52% në zona urbane). Duket se organizatat e shoqërisë civile janë më të pranishme në zonat urbane, por prani e tyre në zonat rurale është po aq e rëndësishme.¹⁴ Nga ana tjetër, duke marrë parasysh faktin se ligji për OJF lejon shoqatat që të kenë anëtarësi dhe të funksionojnë vetëm me të, përqindja e pjesëmarrësve që raportuan të jenë anëtarë të një OJF/shoqate¹⁵ mund të konsiderohet e lartë.

Grafiku 4. Burimet e informacionit




13 Misioni i vëzhguesve të zgjedhjeve nga OSCE/ODIHR (2015). Raporti Përfundimtar për Zgjedhjet Vendore 2015. E marrë nga <http://www.osce.org/albania> e aksesuar në prill 2016

14 Ligji nr. 8788, dt.7.05.2001 "Për Organizatat jo-fitimprurëse" lejon vetëm shoqatat që të funksionon mbi bazën e anëtarësisë.

15 Ligji nr. 8788, dt.7.05.2001 "Për Organizatat jo-fitimprurëse"

Grafiku 5. Anëtarësimi në një parti politike ose OJF/shoqatë



Megjithatë, për shkak të faktit se pyetësi ka qenë me vetë-raportim mund të supozohet se ata janë aktivisht të angazhuar në një organizatë dhe ta perceptojnë veten si anëtarë të saj, gjë që mund të jetë më e rëndësishme sesa anëtarësimi në mënyrë zyrtare.

Anëtarët e një partie politike ishin më shumë burra (63.7%) sesa gra (36.3%). Në Shqipëri, ashtu si edhe në vende të tjera, ekziston mentaliteti se politika është punë “burrash”. Në mënyrë interesante, pjesëmarrësit me nivele më të ulëta arsimit (8/9 vjeçare), të papunët ose studentët kishin më pak gjasa të raportonin se ishin pjesë e një partie politike.

Në kontrast me anëtarësimin në një parti politike, pjesëmarrësit e rinj kishin më shumë gjasa të angazhoheshin në një OJF/shoqatë të tjera. Nivelet e arsimit treguan një ndryshim interesant, ata me arsim të mesëm janë më të angazhuar me partitë politike, ndërsa ata me arsim të lartë me OJF. Pjesëmarrësit e papunë kishin më pak gjasa të ishin anëtarë të OJF/shoqatave. Duket se organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat janë më tërheqëse për individët nga publiku me arsim më të lartë. Megjithatë, pjesa tjetër e pjesëmarrësve (siç paraqitet dhe nga të dhënat) nuk janë të ndërgjegjshëm për ekzistencën ose misionin e tyre (Tabela 1).

Tabela 1. Anëtarësimi në një parti politike përkundrejt anëtarësimin në OJF/shoqata, ndryshime demografike

	Anëtarësimi në parti politike				
	Rural/urban	Gjinia	Mosha	Arsimi	Punësimi
Më shumë gjasa	Urban	Meshkuj	Asnjë ndryshim	Të gjitha nivelet	Sektori publik
Më pak gjasa	Rural	Femra	Asnjë ndryshim	8/9 vjeçare	Të papunë/Studentët
	Anëtarësimi në OJF/shoqata				
	Rural/urban	Gjinia	Mosha	Arsimi	Punësimi
Më shumë gjasa	Urban	Asnjë ndryshim	Nën 35 vjeç	I lartë	Asnjë ndryshim
Më pak gjasa	Rural	Asnjë ndryshim	Mbi 65 vjeç	Fillor	Të papunë


Kur njerëzit dëgjojnë termin “politikë”, ata e lidhin atë me “angazhimin në parti politike”, sipas diskutimit të ekspertëve në fokus grup. Kjo bindje u konfirmua dhe nga studimi, sipas të cilit një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish mendojnë se angazhimi politik është angazhimi në një parti politike (44.1%). Megjithatë, kishte pjesëmarrës të tjerë që besonin se është edhe angazhimi në një parti politike edhe jo (24.8%), ndërsa

vetëm 1 nga 5 pjesëmarrësit mendojnë se mund të angazhohesh politikisht pa qenë nevoja të jesh anëtar i ndonjë partie politike (21.9%) (Grafiku 6). Individët nga zonat urbane, punonjësit e sektorit publik dhe pensionistët janë me përqindje më të larta në grupin e pjesëmarrësve që mendojnë se “politikë” është angazhim në parti politike. Në kontrast me ta, pjesëmarrësit e rinj kishin më pak gjasa të mendonin një gjë të tillë.

Siç u shpjegua në fillim të raportit, angazhimi politik shkon përtej thjesht angazhimit në një parti politike. Norris (2000) beson se angazhimi politik përfshin informimin, pjesëmarrjen politike dhe besimin politik.¹⁶ Për rrjedhojë, një individ i interesuar për çështjet publike informohet vazhdimisht dhe ndërmer veprime për të ndryshuar një situatë/ gjendje me të cilën është i/e pakënaqur. Në këtë kuptim, nëse angazhimi politik do të ishte i lidhur vetëm me partitë politike spektri i nismave, interesave dhe informacionit si dhe natyra e pjesëmarrjes do të kushtëzoheshin nga anëtarësimi në parti. Në diskutimet ne fokus grupe përmendej se pjesëmarrja në një protestë të organizuar nga shoqëria civile për të adresuar një çështje shqetësuese mund të rezultojë në presion politik për individët-anëtarë të partive politike.


Thuajse **gjysma** e pjesëmarrësve nuk ishin mbështetës të ndonjë partie politike (45.5%) dhe 1 nga 4 nuk ishin mbështetës të fortë (24.9%). Një përqindje e vogël e pjesëmarrësve ishin mbështetës të fortë (11.3%) ose mjaftueshëm të fortë (15.6%) të një partie. Në total, **2 nga 3 pjesëmarrësit nuk janë mbështetës të ndonjë partie politike** (Grafiku 7). Prej atyre që thanë se nuk janë mbështetës të ndonjë partie politike, 49.2% ishin nga zonat urbane dhe 41.3% nga zonat rurale. Një numër i vogël i pjesëmarrësve të rinj raportuan se janë mbështetës të një partie politike (21.4%). Ishte interesante se pjesëmarrësit me arsim të lartë ishin më të pranishëm mes mbështetësve, diçka që është në përputhje me rezultatet e mëvonshme për arsimin e lartë dhe nivelet e kënaqësisë, ndikimit personal në vendimmarrje dhe angazhimin. Gratë ka më shumë gjasa se burrat që të mos jenë mbështetëse të ndonjë partie politike. Kryqëzimet të dhënave tregojnë se mbështetësit e partive politike janë më aktivë në kontaktimin e zyrtarëve vendorë ose deputetëve, në pjesëmarrjen në fushata ose demonstrate të organizuara nga partitë politike dhe në pjesëmarrjen në takime të bashkisë dhe në konsultime me publikun.

Grafiku 6. Angazhimi politik është...



16 Norris, P. (2000). *A Virtuous Circle: Political Communications in Post-Industrial Societies*. New York: Cambridge University Press

Grafiku 7. Mbështetësit e një partie politike




2.2.2. Pjesëmarrja politike në nivel vendor ose kombëtar

Studimet tregojnë se niveli vendor dhe rajonal kanë një tërheqje më të madhe për përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve, krahasuar me nivele më të larta. Afërsia, marrëdhëniet më të lehta për t'u kuptuar dhe ndikimi potencialisht më i madh i qytetarëve në vendimmarrje janë sigurisht një disa nga arsyt.¹⁷ Pjesëmarrësit

e këtij studimi ishin më pak të gatshëm për t'u angazhuar në nivel kombëtar (33%) sesa në nivel vendor (51.6%) (Grafiku 8). Pjesëmarrësit e rinj me arsim të larta kishin më pak mundësi të përfshiheshin në nivel vendor. Anëtarët e OJF/shoqatave kishin më shumë dëshirë të përfshiheshin në nivel vendor sesa pjesëmarrësit e tjerë të studimit. Ata me më pak mundësi për t'u përfshirë në nivel kombëtar vinin nga zonat rurale, me arsim të ulët dhe jo të punësuar në sektorin publik.

Grafiku 8. Përfshirja në nivel vendor dhe qendror



17 Fraenkel-Haeberle, C., Kropp, S., Palermo, F. and Sommermann, K. P. (2015). Citizen Participation in Multi-level Democracies. Boston: Brill – Nijhoff, pp. 11

Prej anëtarëve të partive politike gjysma e tyre do të dëshironin të përfshiheshin në nivel vendor, diçka që ishte dy herë më shumë sesa kampioni në total. Kjo ishte e vërtetë edhe për anëtarët e OJF/shoqatave.


Dëshira dhe vullneti për t'u përfshirë në çështje publike dhe vendimmarrjen është një hap i parë i rëndësishëm drejt angazhimit politik. Pjesëmarrësit në studim në përgjithësi hezitojnë të marrin pjesë në vendimmarrje, ndihen sikur ata nuk kanë zërin e tyre në këtë proces, sikurse u tha gjatë diskutimeve në fokus grupe.

Duke vënë theksin në dallimet mes zonave rurale dhe urbane grafiku i mëposhtëm (Grafiku 9) tregon qartë prirjen e pjesëmarrësve të zonave rurale për të qenë më afër me nivelin vendor. Nga ana tjetër, ndryshimet nga reforma territoriale në nivel vendor mund të ketë një ndikim të dyfishtë: qytetarët mund të jenë më të interesuar për të

ditur se si funksionojnë njësitë administrative, por edhe mund të jenë të paqartë dhe dekurajohen nga ndryshimet dhe nga fakti se nuk kanë informacion të mjaftueshëm. Përfshirja e drejtuesve politikë në procesin e angazhimit të qytetarëve ndihmon në largimin e perceptimit të zakonshëm se politikanët fshehin informacion, dhe lejon që angazhimi të jetë më i sigurtë, i hapur dhe transparent. Zyrtarët vendorë janë po ashtu të aftë të vendosin objektiva të qarta për të ndihmuar në drejtimin e pjesëmarrjes dhe angazhimit të publikut që është në një linjë me aktivitetet e tjera.¹⁸ Pjesëmarrësit e fokus grupeve sugjeruan ndryshime të ngjashme dhe dhanë shembuj të deputetëve dhe këshilltarëve bashkiakë që janë më aktivë dhe transparentë.

¹⁸ Lipcsei, R., Bruce, B. & Vinodrai, T. (2015). Evolving the competitive edge: rural community engagement. Economic Developers Council of Ontario (EDCO). E marrë nga <http://events.tamarackcommunity.org/latest/community-engagement-in-rural-areas> e aksesuar në 28 mars 2016

Grafiku 9. Ndryshime mes zonave rurale-urbane në përfshirjen në vendimmarrje



2.2.3. Pjesëmarrja dhe veprimi politik

Sipas Hansard Society¹⁹, angazhimi politik mund të matet në terma të asaj që njerëzit mendojnë dhe bëjnë, por edhe me nismat që janë gati të bëjnë në të ardhme nëse shqetësohen ose interesohen shumë për një çështje.

Pjesëmarrja politike mund t'i referohet një sërë aktiviteteve përmes të cilave njerëzit kërkojnë të ndikojnë në vendimmarrjen që formëson jetën e tyre.²⁰ Kjo pjesëmarrje mund të synojë ndikimin tek organizatat publike, private dhe të sektorit të tretë²¹ dhe përfshin:

- Pjesëmarrjen formale në forume dhe procese. Në këtë formë përfshihen zgjedhja e përfaqësuesve si dhe përfshirja e drejtpërdrejtë, p. sh. në referendum, parti politike dhe pjesëmarrje në takime publike.
- Pjesëmarrjen informale, e cila qëndron jashtë mjedisit zyrtar dhe përmban një sërë aktiviteteve "poshtë-lartë". Për shembull, aktivizmi online si nënshkrimi i një peticioni, blerja ose bojkotimi i produkteve për arsye politike, dhe diskutimi për politikën me miqtë dhe familjen.²²

2.2.4. Siguria për pjesëmarrjen në votim

1 nga 2 pjesëmarrësit me siguri do të votonin nëse zgjedhjet do të bëheshin gjatë javës që u realizua pyetësi dhe vetëm 22.6% me shumë gjasa nuk do të votonin. Diskutimet në fokus grupe zbulojnë se një sërë pjesëmarrësish e konsiderojnë pjesëmarrjen në votim si të vetmin pushtet që kanë, ndërsa të tjerë deklarojnë se kanë humbur shpresat se votimi do të sjellë ndryshimin e dëshiruar. Ata shprehin zhgënjimin e tyre me

kandidatët aktualë duke thënë disa herë se kanë nevojë për fytyra dhe njerëz të rinj në politikë. Vlen të përmendet se anëtarët e OJF, punonjësit e sektorit publik dhe më shumë anëtarët e partive politike ishin më shumë të predispozuar të votonin, edhe pse përqindja e tyre në total në këtë studim ishte e ulët. Pjesëmarrësit me më pak gjasa për të votuar ishin ata me arsim fillor. Këto prirje janë në përputhje me rezultatet e pyetjeve të tjera, d.m.th., pjesëmarrësit me arsim fillor në këtë studim kishin më pak gjasa të përfshiheshin në vendimmarrje si në nivel vendor ashtu dhe në nivel qendror (Grafiku 10). Në të njëjtën linjë, ata kishin më shumë mundësi të ndiheshin të pashpresë dhe raportonin se kishin ndërmarrë më pak veprime për të ndryshuar një situatë që nuk e pëlqenin.

Grafiku 11 tregon prirjet në mënyrat formale dhe informale të pjesëmarrjes si dhe ndryshimin mes nismave që pjesëmarrësit kanë ndërmarrë dhe atyre që do ishin të gatshëm të ndërmerrnin, nëse atyre u interesonte shumë një çështje. Veprimi më i shpeshtë i pjesëmarrësve gjatë 12 muajve të fundit kanë qenë diskutimi për politikën ose për një çështje specifike me njerëz të tjerë (74.5%). Kontaktimi i një anëtar të këshillit bashkiak ose punonjësi të zyrave vendore ishte veprimi i dytë më i shpeshtë (35.7%) i pasuar nga vullnetarizmi për një aktivitet në komunitetin vendor (32%). Në përgjithësi, burrat prireshin të ndërmerrnin më shumë nisma se gratë së bashku me pjesëmarrësit e zonave urbane. Sikurse mund të shihet dhe në grafik, rreth 10.9% të pjesëmarrësve raportuan se nuk kanë ndërmarrë asnjë nismë; edhe pse kjo është një përqindje e ulët, në fakt duke marrë parasysh se ka shumë nisma të renditura në pyetje (p.sh. shumë njerëz munden që thjesht të diskutojnë për politikën ose një çështje që i intereson me njerëz të tjerë) mund të mendohet si e lartë. Megjithatë, në studimin e Analizimit të Angazhimit Politik në Serbi²³ rezultatet ishin akoma më të ulëta. Qytetarët serbë rrethuan më shumë alternativën "asnjë nga sa më sipër".

19 Hansard Society, Audit of Political Engagement Reports 1-12. Shih: <http://www.auditofpoliticalengagement.org/reports>, e aksesuar në prill 2016.


20 Fox, S. (2014). Is it Time to Update the Definition of Political Participation? Review of "Political Participation in Britain: The Decline and Review of Civil Culture. Parliamentary Affairs. 67, fq. 495-505

21 Flinders, M. (2012). Debating Demonization: In Defence of Politics, Politicians and Political Science. Contemporary Politics. 18 (3), fq. 355-366


22 Cunningham, M. Flinders, M. (2015). *Participatory Arts and Political Engagement*. Arts and Humanities Research Council.

23 Otvoreni Parlament (2015). Audit of political engagement 2015: Public opinion poll on citizen participation in democratic processes in Serbia. E marrë nga <http://www.otvoreniparlament.rs/wp-content/uploads/2015/09/Audit-of-political-engagment-in-Serbia-2015.pdf> e aksesuar në prill 2016

Grafiku 10. Siguria për të votuar në grupe të ndryshme



Grafiku 11. Nismat e ndërmarra përkundrejt gatishmërisë për t'u angazhuar




Në përgjithësi, vihet re një rritje në gatishmërinë e pjesëmarrësve për të ndërmarrë veprime nëse do të interesoheshin shumë për një çështje. Në këtë rast, mënyrat më aktive dhe formale të pjesëmarrjes janë më të shpeshta sesa ato më pasive ose informale. Sërish, burrat dhe pjesëmarrësit nga zonat urbane ishin më të gatshëm për të vepruar sesa të anketuarit nga grupet e tjera.

Grafiku 12. Ndryshime mes niveleve vendore dhe qendrore në nismat e ndërmarra

2.2.5. Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen dhe angazhimin politik

Arsyet më të shpeshta për të mos ndërmarrë veprime lidheshin me besimin e pjesëmarrësve se askush nuk i dëgjon (39.2%), se politikanët mendojnë vetëm për veten e tyre (38.7%) ose se ata nuk interesohen për njerëzit e thjeshtë (22.8%). Pjesëmarrësit e zonave urbane prireshin të raportonin se politikanët janë



Studimet evidentojnë shqetësimin se mungesa e angazhimit në politikën formale ndikon më shumë disa sektorë të caktuar të shoqërisë. Megjithatë, nuk është e qartë nëse kjo do të thotë se disa njerëz largohen nga politika në përgjithësi, apo nëse ata angazhohen në mënyra jo-formale të pjesëmarrjes.²⁴ Institucionet demokratike mund të jenë në gjendje ta shfrytëzojnë interesin për pjesëmarrjen politike informale si një mënyrë për të rritur angazhimin edhe në procese formale. Sfidat më të mëdha qëndrojnë rreth angazhimit të njerëzve që nuk janë të angazhuar në asnjë nga proceset, si formalet ashtu dhe jo-formalet.

vetëm për veten e tyre ose se sistemi nuk i lejon që të ndikojnë. Në përgjithësi fajësonin sistemin. Në diskutimet në fokus grupe pjesëmarrësit u shprehën se sistemi elektoral nuk i lejon të zgjedhin as përfaqësuesin e tyre vendor sepse edhe ai/ajo caktohet nga lideri i partisë politike. Pjesëmarrësit e zonave rurale besonin më shumë se politikanët nuk interesohen për njerëz si ata, duke nënkuptuar kështu një bindje të fshehur që mbizotëron në Shqipëri, bindjen se zonat rurale janë të harruara nga politikanët dhe kujtohen vetëm para zgjedhjeve. Gratë kishin më shumë mundësi të raportonin se nuk kishin shumë informacion, edhe pse nuk ishte një nga alternativat e qarkuara më shumë. Kjo bindje e qenësishme pasqyron në një farë mënyrë stereotipin se “politika është për burrat”. Në

24 Flinders, M. (2015). Political Fall-Out. Fewer People than Ever are Planning to Vote in the Forthcoming General Election. What is Turning off the Electorate?. Society Now – ESRC Research Making an Impact. 21, fq. 12-13.


arenën politike në Shqipëri dominojnë burrat, të cilët vendosin rregullat e lojës politike. Megjithatë për të ndërtuar demokracinë dhe për ta bërë atë të qëndrueshme, pjesëmarrja e barabartë e grave në politikë dhe në qeveri merr një rëndësi thelbësore.

Studimi ka treguar dhe një dallim tjetër mes niveleve më të larta dhe atyre më të ulëta të arsimit. Sa më i lartë niveli arsimor aq më pak mundësi që pjesëmarrësit të ndihen të pashpresë, domethënë aq më pak mundësi që të qarkohen alternativat: “politikanët nuk interesohen për njerëz si unë”, “sistemi elektoral nënkupton që vota ime nuk ka rëndësi”, “asnjë nuk dëgjon se çfarë kam për të thënë”, “mendimi im nuk është i rëndësishëm” e të tjera. Në shumicën e studimeve të sjelljes politike argumentohet se individët me arsim më të lartë marrin pjesë më shumë në aktivitete politike sesa ata me arsim të ulët. Sipas logjikës së thjeshtë, arsimi supozohet se rrit shprehitë civile dhe njohuritë politike që funksionojnë si mekanizma që nxisin pjesëmarrjen.²⁵

2.2.6. Rrugë për të përmirësuar angazhimin politik

Pyetjet në vazhdim janë në përpjekje për të kuptuar faktorët dhe arsyet që do t'i bënin pjesëmarrësit të angazhoheshin më shumë. Sipas Grafikut 13, shumica e pjesëmarrësve ishin të gatshëm të angazhoheshin për interesa/përfitime personale (80.9%), për të mbështetur familjen dhe miqtë (87.5%) dhe për një interes që ndajnë me qytetarë të tjerë ose me komunitetin e tyre (82.3%). Dëshira për t'u angazhuar është më e ulët kur është fjala për një çështje që e besojnë por që nuk lidhet me ta personalisht (65.9%), megjithëse edhe në këtë rast thuajse 2 nga 3 pjesëmarrësit do e bënin dhe këtë. Vlen të përmenden se anëtarët e partive politike prireshin më shumë për t'u angazhuar për të gjitha arsyet e mësipërme, në një linjë me prirjen e përgjithshme, krahasuar me jo-anëtarët. E njëjta gjë vlen dhe për anëtarët e OJF-ve/shoqatave krahasuar me ata që nuk ishin anëtarë. Një ndryshim i rëndësishëm për t'u theksuar u vu re në lidhje me interesin për t'u angazhuar për një çështje që ndajnë bashkë me qytetarë të tjerë ose me komunitetin, ku anëtarët e një OJF-je/shoqate

Grafiku 13. Arsye për t'u angazhuar



25 Persson, M. (2015). *Education and Political Participation*. British Journal of Political Science. 45 (3), fq: 689 - 703

ishin të gatshëm ta bënin në një nivel shumë të lartë (91%) më shumë në krahasim me jo-anëtarët (81%). I njëjti ndryshim ishte evident dhe në lidhje me një kauzë që besojnë por që nuk lidhet me ta personalisht. 80% e anëtarëve të OJF-ve/shoqatave ishin të gatshëm që ta bënin, ndërsa vetëm 65% të atyre që nuk ishin anëtarë raportuan se do e bënin. Për rrjedhojë, vlen të theksohet se angazhimi i pjesëmarrësve për arsye më të mëdha që shkojnë përtej interesave personale lidhet me anëtarësinë në një OJF ose shoqatë.

Ka një dakordësi të përgjithshme në shkencat sociale dhe në disiplinat përkatëse për rolin e rëndësishëm dhe influencës që kanë mediat në formimin e angazhimit politik dhe civil. Mediat janë një transmetues informacioni, një burim informacioni dhe hapësirë publike në të cilën mund të realizohet pjesëmarrja (Delli Carpini 2004).²⁶ Nga ana tjetër, mediat në Shqipëri luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në adresimin e çështjeve shqetësuese për qytetarët, veçanërisht disa emisione televizive si “Fiks Fare” ose “Stop”, të cilat përdorin gazetarinë investigative për të denoncuar publikisht shkeljet. Politikanët shpesh reagojnë më shpejt ndaj emisioneve të tilla sesa ndaj ankesave që vijnë drejtpërsëdrejti nga qytetarët. Për rrjedhojë, nuk ishte habi që pjesëmarrësit e këtij studimi besonin se mënyra më e mirë për të ndryshuar një situatë me të cilën nuk janë të kënaqur ishte të tërheqin vëmendjen e medias për problemin (53.5%) dhe e dyta në radhë ishte votimi në zgjedhje (50.7%), e pasuar nga pjesëmarrja në aktivitete të organizuara nga qytetarët për të ushtruar presion ndaj vendimmarrësve (48.1%). Anëtarësimi në një parti politike ishte më pak e raportuar (19.9%). Prirje të ngjashme vihen re edhe në Analizën e Angazhimit Politik 2015 në Serbi.²⁷ Nga ana tjetër, është interesant fakti se anëtarësimi në një parti politike në Serbi konsiderohej më shumë nga të anketuarit (32%),²⁸ ndërsa në

26 Delli Carpini, M. X. (2004). *Mediating Democratic Engagement: The Impact of Communications on Citizens' involvement in Political and Civic Life*. Në *Handbook of Political Communication Research*, ed. Lynda Lee Kaid. Mahwah, NJ: LEA Publishers

27 Qytetarët serbë besojnë gjithashtu se tërheqja e vëmendjes së medias është një mënyrë për të ndryshuar gjërat (40%) dhe pastaj për të votuar në zgjedhjet vendore (39%) ose parlamentare (37%).

28 Otvoreni Parlament (2015). *Audit of political engagement 2015: Public opinion poll on citizen participation in*

Shqipëri ishte rruga më pak e preferuar.

Besimi tek deputetët ose anëtarët e këshillave bashkiake për të ndryshuar një situatë me të cilën pjesëmarrësit nuk ishin të kënaqur ishte në nivele shumë të ulëta. Vetëm 1 nga 4 pjesëmarrës mendonte se po të kontaktonte një nga këta të dy do të ndryshonte situatën. Edhe organizatat e shoqërisë civile kanë përqindje të ulëta të besimit, diçka që përbën një thirrje për OSHC për të shkuar më shumë në komunitet në mënyrë që të ndërtojnë mbështetjen e publikut dhe të rindërtojnë ose rivendosin besimin. Diskutimet në fokus grup japin shpjegime për disa nga arsyet pse pjesëmarrësit mendojnë në këtë formë. Ata shpeshherë përmendin se OSHC janë të përqendruara në Tiranë, se nuk kanë mjetet financiare për të bërë punën e tyre dhe se ndonjëherë bashkëpunojnë me partitë politike. Gjithashtu, anëtarësimi në parti politike, si një mënyrë formale për pjesëmarrjen dhe angazhimin ishte më pak e përmendur si alternativë. Këto rezultate konfirmojnë studime të mëparshme në Shqipëri, sipas të cilave niveli i interesit për t'u përfshirë në politikë është i ulët në të dy gjinitë, duke theksuar faktin se konsiderohet “biznes i pisët” si dhe duke pasur parasysh frikën e njerëzve se mos humbasin punën e tyre nëse e bëjnë (anëtarësohen në parti politike).²⁹

Pjesëmarrësit zgjedhën alternativat që janë mjeti i fundit për të ndryshuar një situatë, tërheqjen e vëmendjes së medias dhe votimin në zgjedhje. Edhe pse votimi në zgjedhje është një tregues pozitiv, ai ndodh zakonisht një herë në 2 ose 4 vjet. Diskutimet në fokus grupe shpjegojnë arsyet për këtë rezultat. Pjesëmarrësit thanë se ata ndihen se është i vetmi pushtet që kanë, pasi çdo përpjekje tjetër që ata kanë bërë gjatë viteve të fundit ka dështuar. Këto rezultate janë në përputhje me sondazhin e fundit për besimin në qeveri, sipas të cilit parlament dhe partitë politike janë dy nga institucionet më pak të besuara, me shifra në rënie. Organizatat ndërkombëtare ishin më të besuarat, së bashku me institucionet

democratic processes in Serbia. E marrë nga <http://www.otvoreniparlament.rs/ep-content/uploads/2015/09/Audit-of-political-engagment-in-Serbia-2015.pdf> e aksesuar në prill 2016.


29 National Democratic Institute (NDI) (2015). *Focus Group Research Report: findings from public opinion research in Albania*. Tirana, Albania

fetare. Mediat ishin një nga institucionet e besuara, me një besim të qëndrueshëm në vite (34%).³⁰ Pavarësisht besimit të tyre të ulët, pjesëmarrësit e fokus grupeve raportuan se nëse këto përpjekje për të ndryshuar diçka do të ishin të suksesshme, ata do të ishin më të gatshëm që të angazhoheshin.

Një tjetër tregues pozitiv, i përmendur nga 1 në 2 pjesëmarrës, ishte pjesëmarrja në aktivitete të organizuara nga qytetarët për të ushtruar presion. Nga diskutimet në fokus grupe raportohen shumë shembuj në mbështetje të këtij treguesi, përfshirë këtu edhe shembullin e përpjekjeve të fundit për të ushtruar presion te qeverisja vendore për ndalimin e ndërhyrjes në hapësirat publike pa konsultim paraprak me qytetarët.

‘Edukimi rrit pjesëmarrjen pak a shumë duke zhvilluar shprehitë që janë të rëndësishme për politikën-aftësinë për të folur dhe për të shkruar, njohurinë se si të përballesh në mjedise organizatash.’³¹ Dhe Lewis-Beck et al. theksojnë se: ‘Me më shumë edukim formal vjen dhe interesi më i fortë për politikën, një shqetësim më i madh për zgjedhjet, më shumë besim për kryerjen e rolit si qytetar, dhe një përkushtim më i madh ndaj normës së të qenit një qytetar i mirë’.³² Për rrjedhojë, edukimi rrit aftësitë dhe njohuritë, por nuk të ndikojë në interesin politik dhe efikasitetin; faktorë që në vetvete nxisin pjesëmarrjen.³³

Grafiku 14. Aktivitete për të kontribuar në ndryshimin e situatave



Pjesëmarrësit, po ashtu, kujtojnë përvojën e suksesshme të protestave kundër “armëve kimike” në Shqipëri, për shumë prej tyre ishte i vetmi aktivitet masiv i qytetarëve që provoi se ata mund të sjellin ndryshim. Pjesëmarrësit me arsim të lartë nga zonat urbane prireshin të ndërmerrnin veprime më konkrete krahasuar me ata me arsim të ulët dhe nga zonat rurale.

30 IDM (2015). Besimi tek qeveria. Tirana: Lame dhe Papa, fq. 5

31 Verba, S., Schlozman, K.L. and Brady, H. (1995). *Voice and Equality: Civic Voluntarism in American Politics*. Cambridge, Mass.: Harvard University Press

32 Lewis-Beck, M.S., Jacoby, w., Norpoth, H. and Eëisberg, H. F. (2008). *The American Voter Revisited*. Ann Arbor: University of Michigan Press

33 Persson, M. (2015). *Education and Political Participation*. *British Journal of Political Science*. 45 (3), fq: 689 - 703


2.2.7. Rritja e pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje

Pjesëmarrja e lartë në votime shpeshherë konsiderohet e dëshirueshme, edhe pse mes shkencëtarëve politikë dhe ekonomistëve të specializuar në zgjedhjet e publikut kjo çështje është ende temë debati.³⁴ Pjesëmarrja e lartë shihet si dëshmi e legjitimitetit të sistemit aktual, edhe pse disa shkencëtarë politikë vënë në pikëpyetje besimin se kjo pjesëmarrja është një lloj miratimi i nënkuptuar i sistemit.³⁵

ata, apo mbase i shohin si më autonomë sesa vetë banorët në Shqipëri, pikërisht ngaqë nuk jetojnë këtu.

Votimi elektronik si një mënyrë për të rritur pjesëmarrjen në votime ishte një mënyrë e sugjeruar nga gjysma e pjesëmarrësve, sikundër ndodh dhe gjatë debateve reale për këtë çështje. 43.2% e kampionit ishin pro kësaj metode dhe 47.3% ishin kundër. Pjesëmarrësit më të moshuar dhe me arsim të ulët ishin më

Grafiku 15. Përmirësimi i pjesëmarrjes në votime



Pjesëmarrësit e studimit sugjerojnë mënyrat që mendojnë se janë më të rëndësishme për të rritur pjesëmarrjen në votime. Ndryshimi më i zakonshëm, sipas tyre, për të përmirësuar pjesëmarrjen në votime ishte votimi i emigrantëve në vendbanimin e tyre aktual (82.4%). Këtë sugjerim e jepnin më shumë burrat dhe gratë nga zonat rurale dhe me arsim të ulët. Pjesëmarrësit e zonave urbane dhe me arsim të lartë mund të bëhen më skeptikë për potencialin e abuzimit me këtë zgjidhje.³⁶ Shumica e familjeve shqiptare kanë një të afërm emigrant dhe ndoshta identifikohen me

pak të prirur të mbështesnin këtë opion.

Të dyja sugjerimet e mësipërme bazohen në të ashtuquajturën "lehtësinë për të votuar". Shkencëtarët politikë mendojnë se nëse publiku do të kishte mënyra më të lehta për të votuar ata do të votonin.³⁷ Ky është rasti i emigrantëve dhe i votimit elektronik. Megjithatë, votimi i emigrantëve në vendin ku jetojnë është një nga çështjet që diskutohet shumë para zgjedhjeve, kryesisht ngaqë mendohet se do të rriste probabilitetin për korrupsion. Disa shtete si Estonia, Franca ose Zvicra përdorin votimin përmes internetit. Por, shtete të tjera shprehin shqetësimet e tyre

34 Shih Mark N. Franklin. (1999). Electoral Engineering and Cross National Turnout Differences. *British Journal of Political Science*, 29 (1), fq. 205-216 që përpiket të sfidojë këtë konsensus

35 Po aty.


36 Ky shpjegim u mbështet gjatë takimit me ekspertët

37 Blais, A., Dobrzynska, A. & Loeëen, P. (2007). Potential Impacts of Extended Advance Voting on Voter Turnout. Working paper series.

të lidhura me sigurinë e kësaj mënyre. Për shembull, Departamenti i Mbrojtjes në SHBA ka shqyrtuar mundësinë për votim me internet, por e ka anuluar këtë përpjekje.³⁸ Ideja është se do të rritej pjesëmarrja, sepse njerëzit do të votonin nga shtëpia e tyre, por eksperimentet që janë bërë me votimin nëpërmjet internetit kanë sjellë rezultate të ndryshme.

Vota bosh³⁹ si alternativë raportohet nga pothuajse gjysma e pjesëmarrësve. Megjithatë, një përqindje e konsiderueshme e këtyre të fundit besonin se alternativa e votës bosh nuk do të rriste pjesëmarrjen në votime (39.8%). Pjesëmarrësit më të moshuar ishin më pak dakord me këtë alternativë, ndërsa ata me arsim të lartë më shumë dakord. Kjo mënyrë ndoshta do të ndihmonte edhe për të qartësuar se çfarë tregojnë nivelet aktuale të pjesëmarrjes në zgjedhje. Aktualisht supozohet se një pjesëmarrje e ulët është reflektim i zhgënjimit ose indiferencës, edhe pse nuk mund të jemi të sigurt për këtë. Nëse

Grafiku 16. Sa të kënaqur jeni me punën e...



38 "Internet voting is just too hackable, say security experts". USA TODAY. E marrë nga <http://www.usatoday.com/story/tech/neës/2016/01/28/internet-voting-not-ready-prime-time-security-risks/79456776/> e aksesuar në 28 mars 2016

39 Votë bosh do të thotë mosdhënia e votës për asnjë kandidat në zgjedhje për të demonstruar pakënaqësinë e votuesit me kandidatët ose refuzimin e sistemit politik aktual. Forma më e shpeshtë është ajo përfshirjes së alternativës "asnjë nga sa më sipër" në fletën e votimit.

në fletën e votimit do të përfshihej edhe alternativa "asnjë nga më sipër", atëherë pjesëmarrja e ulët do ishte me të vërtetë tregues i apatisë së qytetarëve për të votuar.

Situatë e ngjashme raportohet dhe për votimin që në moshën 16 vjeçare. Pjesëmarrësit nga zonat urbane, të rinj apo të moshuar, prireshin të mos e mbështesnin këtë alternativë. Kjo prirje mund të shpjegohet me skepticizmin më të madh të këtij grupi, veçanërisht atyre me arsim të lartë, siç argumentohet nga grupi i ekspertëve. Kjo prirje reflekton debatin ndërkombëtar për uljen e moshës minimale për të votuar si një mënyrë për të rritur pjesëmarrjen në votim. Argumenti kryesor i studiuesve kundër kësaj metode qëndron në faktin se njerëzit nën moshën 18 vjeç nuk kanë aftësinë dhe motivimin për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procese zgjedhore.⁴⁰ Mbështetësit e një reforme të tillë argumentojnë se ulja e moshës së votimit do të sillte një ndikim pozitiv në pjesëmarrjen në zgjedhje. Arsyeja lidhet me faktin se votuesit

nën 18 vjeç jetojnë ende me familjet e tyre dhe ka mundësi që të jenë në shkollë, dy faktorë që kanë treguar se inkurajojnë pjesëmarrjen

40 Chan, T.W. and Clayton, M. (2006). Should the Voting Age Be Lowered to Sixteen? Normative and Empirical Considerations. *Political Studies*, 54. fq. 533-558

përmes një sërë mekanizmesh socializimi.⁴¹


2.3. Efikasiteti dhe kënaqësia

Seksioni i fundit që lidhej me treguesit synonte të maste kënaqësitë kënaqshmërinë e pjesëmarrësve me punën e qeverisë, Parlamentit dhe opozitës aktuale. Më shumë se 1 nga 2 pjesëmarrësit janë të pakënaqur nga puna e parlamentit aktual (57.5%) dhe të qeverisë (56.8%). 2 nga 3 pjesëmarrësit nuk janë të kënaqur nga puna e opozitës aktuale (69.3%) (Grafiku 16). Prirjet tregojnë se pjesëmarrësit ndjejnë se si qeveria ashtu dhe parlament nuk përfaqësojnë ose u shërbejnë mirë qytetarët, ndërsa është akoma më e vlerësimit të rolit të opozitës. Diskutimet në fokus grupe shtojnë vlerë në shpjegimin e këtyre përqindjeve, ku shpeshherë thuhej se qeveria nuk punon ndërsa opozita është pasive. Pjesëmarrësit dhanë shembuj të pakënaqshmërisë së tyre si nga qeveria ashtu edhe nga opozita. Kryqëzimet e të dhënave tregojnë se pjesëmarrësit më të kënaqur kishin edhe më shumë njohuri dhe më shumë interes për politikën. Prirje të ngjashme për qeverinë, por jo kaq të larta, u raportuan dhe në Analizën e Angazhimit Politik në Serbi, ku niveli i pakënaqësisë së edhe atje ishte rritur. Në

lidhje me Parlamentin, rezultatet ishin thuajse të njëjta me Serbinë (43% të pakënaqur). Pjesëmarrësit me nivelet më të ulëta të arsimit (fillor), më të moshuarit (mbi 65 vjeç) dhe ata që vinin nga zonat rurale pavarësisht gjinisë prireshin të ishin më të pakënaqur.

Pjesëmarrësit nuk besonin se kishin pushtet për të ndikuar në vendimmarrjen si në zonën e tyre, atje ku jetonin, si në vendin në tërësi. Më shumë se 1 nga 2 pjesëmarrësit perceptonin se nuk kishin asnjë lloj ndikimi (58.7%) në nivel vendor dhe më shumë se 2 nga 3 pjesëmarrësit në nivel kombëtar (Grafiku 17). Gratë më shumë se burrat mendonin se nuk kishin asnjë pushtet për të ndikuar në vendimmarrje. Edhe pjesëmarrësit nga zonat rurale mendonin se kishin më pak pushtet mbi vendimmarrjen të të dy nivelet. Sa më i ulët niveli i arsimit aq më shumë mendonin pjesëmarrësit se nuk kishin ndikim. Këto rezultate konsiderohen shqetësuese për shëndetin e demokracisë. Megjithatë, prirje të ngjashme vihen re dhe në vende të tjera, si p.sh., në Skoci ose në Serbi.⁴² Në vendet më të zhvilluara si Britania e Madhe, këto rezultate ishin më të larta për nivelin qendror. Ndjesia e vazhdueshme e zhgënjimit, mungesa e perceptuar e ndikimit dhe pakënaqësia e vazhdueshme me tre institucionet e qeverisë të rëndësishme mund të dëmtojnë shëndetin e demokracisë.

Grafiku 17. Perceptimi i ndikimit në nivel vendor dhe qendror



41 Bhatti, Y. and Hansen K.M. (2010). How Turnout Will Decline as the Western Population Grows Older? Paper presented at the ECPR Joint Sessions of Workshops, Münster, Germany.

42 Hansard Society (2015). Audit of political engagement 12. E marrë nga <http://www.auditofpoliticalengagement.org/media/reports/Audit-of-Political-Engagement-12-2015.pdf> e aksesuar në prill 2016

3. PERCEPTIMET PËR PARLAMENTIN DHE PËRFAQËSUESIT E ZGJEDHUR

3.1. Perceptimet për Parlamentin shqiptar

Seksioni i fundit tematik i studimit lidhej me perceptimet për Parlamentin dhe përfaqësuesit e zgjedhur. Një tregues pozitiv ishte se më shumë se gjysma e pjesëmarrësve (53.2%) mendonin se Parlament është i rëndësishëm për demokracinë tonë. Pjesëmarrësit kryesisht nuk ishin dakord (në mënyrë të moderuar ose fuqishëm) me disa prej pohimeve për funksionet kyçe të Parlamentit. Kur u pyetën nëse Parlamenti shqiptar e vendos qeverinë para përgjegjësisë, 42% prej tyre nuk ishin dakord. Në të njëjtën linjë ata nuk ishin dakord me faktin se Parlamenti shqiptar inkurajon pjesëmarrjen e publikut (45%) ose që debaton dhe merr vendime për çështje të rëndësishme për ta (47.5%). Po ashtu, 1 në 2 pjesëmarrës të sondazhit nuk ishin dakord me pohimin se Parlamenti është i hapur ndaj qytetarëve për të marrë pjesë në komisionet parlamentare dhe në seancat plenare (50%). Vlen për t'u përmendur se pjesëmarrësit bënë një dallim të qartë mes pohimeve të mësipërme duke evidentuar funksionet e Parlamentit dhe ato që lidhen me përbërjen e tij, siç do shihet në vazhdim.

Dy pyetjet kryesore të lidhura me përbërjen e Parlamentit kishin edhe përqindjet më të larta të mosmiratimit. Kur u pyetën nëse Parlamenti shqiptar përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur të shoqërisë që punojnë në një mënyrë etike, 2 nga 3 pjesëmarrësit (65.4%) nuk ishin

dakord. Në të njëjtën mënyrë, shumica e tyre nuk ishin dakord (thujse 60%) me pohimin se Parlamenti përfaqëson në mënyrë të drejtë të gjitha grupet e shoqërisë (duke përfshirë gratë, minoritetet dhe grupe të tjera vulnerable). Gratë pak më shumë se burrat nuk ishin dakord me këtë pohim.

Sot, më shumë së kurrë, qytetarët kërkojnë më shumë transparencë nga qeveria e tyre. Informacioni 'kush', 'si' dhe 'pse' që ka të bëjë me vendimmarrjen ka shumë rëndësi me qëllim kërkesën e llogarisë për qeverinë si dhe për të ruajtur besimin tek institucionet publike. Rritja e transparencës është me rëndësi jetike jo vetëm për të ruajtur integritetin në parlament, por kontribuon edhe në përmirësimin e qeverisjes. Parlamenti i hapur dhe transparent mund të përmirësojë shërbimet publike dhe të ulë rrezikun e mashtrimit, korrupsionit dhe shpërdorimit të fondeve publike.⁴³ Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve (56%) deklarojnë se Parlamenti nuk është transparent në mënyrën se si është i organizuar dhe se si funksionon. Pjesëmarrësit e fokus grupeve shprehin pakënaqësinë e tyre me gjuhën e pahijshme që përdoret nga deputetët, me faktin se deputetët zakonisht nuk diskutojnë çështje të qenësishme si dhe me ndjesinë se të gjitha vendimet merren para se të vijnë në Parlament dhe kjo sigurisht nuk kontribuon në kërkesën e llogarisë.


⁴³ OECD (2015). Better life index: civic engagement. E marrë nga <http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/civic-engagement/> e aksesuar në mars 2016.

Edhe pse pyetja shqyrton perceptimet e pjesëmarrësve për funksionet dhe përbërjen e Parlamentit, disa mund të mendojnë se këto perceptime ndikohen nga bindjet politike të vetë pjesëmarrësve dhe nga anëtarësimi në parti politike.⁴⁴ Kryqëzimet e të dhënave mes kësaj pyetjeje dhe niveleve të kënaqësisë me punën e qeverisë aktuale, parlamentit dhe opozitës nuk e mbështesin këtë argument. Konkretisht:

- Pjesëmarrësit e kënaqur me punën e parlamentit kanë perceptime pozitive për funksionet dhe përbërjen e tij;
- Pjesëmarrësit e kënaqur me punën e opozitës nuk mendojnë se parlament e vendos qeverinë para përgjegjësisë. Këto perceptime janë të njëjta dhe për pohimet e tjera.
- Është interesant fakti se pjesëmarrësit e kënaqur me punën e qeverisë kanë perceptime pozitive për funksionet e parlamentit por jo për përbërjen e tij.

Si përfundim, prirjet e mësipërme tregojnë se ka një lidhje mes perceptimeve për Parlamentin dhe kënaqësisë me punën e tij. Perceptimet pozitive lidhen me një kënaqësi më të madhe dhe ato negative me kënaqësi më të madhe nga puna e opozitës. Por në pohime specifike kjo lidhje nuk konfirmohet plotësisht.

Grafiku 18. Perceptimi për funksionet dhe përbërjen e parlamentit shqiptar



44 Ky sugjerim është propozuar nga ekspertët në takimin me ta.

Pjesëmarrësit që kishte më shumë mundësi që të mos ishin dakord me të gjitha pohimet ishin burrat jo-anëtarë të partive politike ose në OJF-ve/shoqatave.

3.2. Perceptime për deputetët dhe këshilltarët vendorë

Më shumë se 2 nga 3 pjesëmarrësit (72.7%) raportuan se nuk mendojnë se përfaqësuesit e zgjedhur trajtojnë interesat e tyre ose të familjeve të tyre, me rezultate të ngjashme për zonat rurale dhe urbane, për të dyja gjinitë. Pjesëmarrësit me arsim të ulët prireshin të besonin se përfaqësuesit e zgjedhur nuk adresojnë interesat e tyre. Në të njëjtën mënyrë, sa më i madh në moshë pjesëmarrësi aq më shumë përforcohej ky besim. Këtu ndikonte edhe papunësia, me pjesëmarrësit e papunë që raportojnë më shumë se të zgjedhurit nuk adresojnë interesat e tyre ose të familjeve të tyre.


Në kundërshtim me jo – anëtarët, ata që ishin anëtarë të partive politike ose të OJF/ shoqate prireshin të mendonin se ata përfaqësohen mirë ose mjaftueshëm. Një studim i mëparshëm në Shqipëri i fokusuar në pushtetin vendor raporton se një përfaqesje nga “lartë-poshtë” për pjesëmarrjen ka çuar në rritjen e informimit dhe besimit të qytetarëve, por jo në fuqizimin dhe aftësimin e tyre t’u

kërkuar llogari të zgjedhurve vendorë.⁴⁵

Gjetjet nga fokus grupet zbulojnë se pjesëmarrësit ndihen të zhgënjyer me përfaqësuesit e zgjedhur, si deputetët ashtu dhe këshilltarët vendorë, për mosmbajtjen e premtimeve, për faktin se nuk janë të pranishëm në komunitetin që përfaqësojnë, se shikojnë vetëm punën e tyre dhe se janë shumë të distancuar nga publiku. Disa mendojnë se deputetët nuk janë përfaqësues “të zgjedhur”, pasi ata caktohen nga lideri i partisë politike duke e bërë akoma më të vështirë njohjen, të kuptuarit dhe, për rrjedhojë, adresimin e interesave të qytetarëve.

Grafiku 19. Deputetët dhe interesat e pjesëmarrësve

çfarë do të thotë të jesh i varfër ose të jetë afër problemeve të popullit (37%) (Grafiku 20). Sikundër shihet në grafikun 20 në alternativën “tjetër”, e cila kishte një përqindje të konsiderueshme, përmendej shpesh “të mos jetë i inkriminuar, të mos jetë përfshirë në aktivitete të paligjshme”. Gjetjet nga diskutimet në fokus grupe shpjegojnë pse kjo përqindje është në nivele të konsiderueshme: në diskursin e fundit politik çështja e parandalimit dhe largimit të personave me dosje kriminale nga zyrat e të zgjedhurve dhe ato publike kanë dominuar jetën politike në vend. Gjithashtu, kjo çështje është mbuluar gjerësisht nga media gjë që mund të ketë ndikuar në perceptimet e pjesëmarrësve.



Kur iu kërkua të tregonin cilësitë më të rëndësishme që duhet të ketë një deputet,⁴⁶ pjesëmarrësit kanë përmendur shumë, mes të cilave ato më të shpeshta ishin: të jetë i ndershëm dhe i përgjegjshëm (59.7%), të jetë i mirë-arsimuar (48.8%) dhe të kuptojë se


Është e dukshme se këto të dhëna janë në përputhje me rezultatet që tregojnë se deputetët dhe zyrtarët e nivelit vendor nuk adresojnë mirë interesat e zgjedhësve të tyre. Gjatë fokus grupeve pjesëmarrësit theksonin nevojën që politikanët të mbajnë premtimet e tyre dhe të kuptojnë jetën e një njeriu të zakonshëm. Shpeshherë raportojnë se deputetët e zonës së tyre nuk interesohen as për të takuar komunitetin. Për këtë fajësojnë vetë deputetët por edhe sistemin zgjedhor. Sipas tyre, ky sistem nuk i lejon qytetarët të zgjedhin deputetin e zonës së tyre.

45 Dauti, M (2013). How Institutions Matter for Local Development: Evidence from the Implementation of Decentralization Reform in Albania. *Arts & Sciences Electronic Theses and Dissertations*. Paper 273. Retrieved from http://openscholarship.wustl.edu/art_sci_etds/273, aksesuar në prill 2016

46 Është e rëndësishme të përmendim se kjo ka qenë një pyetje e hapur. Pjesëmarrësve nuk iu kërkua të jepnin një alternativë specifike dhe intervistuesit u trajnuan që të rrethonin alternativat përkatëse teksa raportoheshin nga pjesëmarrësit.

Përkundrazi, kandidatët për deputet caktohen nga drejtuesi i partisë së tyre politike. Sërish, sipas pjesëmarrësve në fokus grupe, ky fakt thëllon distancën mes dy palëve, qytetarëve dhe deputetëve. Për më tepër, nëse cilësitë perceptohen si standard, është e qartë se pjesëmarrësit kërkojnë standarde minimale për deputetët, si të jetë i mirë-arsimuar, por edhe kjo cilësi ka qenë pjesë e diskursit politik të kohëve të fundit.

Grafiku 20. Cilësi të rëndësishme të një deputeti



mendojnë se ata nuk kanë zyrat në zonën që përfaqësojnë. Fokus grupet vleftësuan dhe shpjeguan më shumë këto marrëdhënie: u tha shumë herë se ata kanë bërë përpjekje për të ndryshuar një situatë duke kontaktuar përfaqësuesit e zgjedhur. Në lidhje me këshilltarët bashkiakë, edhe pse u pohua se janë më të lehtë për t'u kontaktuar, reforma territoriale i ka bërë këto role më të paqarta se më parë. Pjesëmarrësit ndjejnë se qeverisja vendore është më e distancuar

Kur diskutohen aktivitete që mund të rritin llogaridhënien e deputetëve, pjesëmarrësit zgjedhën aktivitetet që vijnë. Së pari, 'sigurimi i kushteve në nivel vendor për të takuar deputetët ose anëtarët e këshillit bashkiak në ditë të caktuara përmes zyrave të tyre ose atyre të bashkisë (76.2%); së dyti, duke 'detyruar deputetët të japin përgjigje për pyetjet e qytetarëve brenda një kohe të arsyeshme' (68.5%). Si në kontrast me këto të dyja, detyrimi për të komunikuar me qytetarët përmes Facebook-ut në përgjithësi nuk kishte të njëjtat rezultate, pasi gjysma e pjesëmarrësve nuk mendonin se do të rriste llogaridhënien (51.3%) (Grafiku 21).

Pjesëmarrësit në fokus grupe e kanë të vështirë të kontaktojnë deputetët, sepse


nga ata për shkak të reformës territoriale. Pjesëmarrësit e zonave rurale prireshin të sugjeronin se sigurimi i kushteve për të takuar deputetët/këshilltarët bashkiakë në nivel vendor do të rriste llogaridhënien në masë të konsiderueshme. Pjesëmarrësit që ishin anëtarë të një partie politike kishin më shumë gjasa të zgjidhnin të dy këto alternativa në përqindje të madhe, ndërsa ata që ishin anëtarë të OJF/shoqatave sugjeronin me më shumë forcë se këto veprime do të rrisnin llogaridhënien. Në asnjë kategori të pjesëmarrësve nuk u raportua se përdorimi më i madh i mediave sociale do të rriste llogaridhënien. Në përgjithësi, pjesëmarrësit e zonave rurale, anëtarët e OJF-ve/shoqatave ose partive politike, të vetë-punësuarit apo

punonjësit e sektorit publik rekomandonin dy alternativat e para (shih grafikun 21). Edhe pse vetëm gjysma e pjesëmarrësve ishin dakord se detyrimi i deputetëve/këshilltarëve për të komunikuar me qytetarët përmes Facebook-ut

do të rriste llogaridhënien gjë që sugjeron se komunikimi me qytetarët nëpërmjet mediave sociale shkon paralelisht me komunikimin e drejtpërdrejtë me ta.

Angazhimi politik funksionon në një sërë

Grafiku 21. Kushte për të rritur llogaridhënien e deputetëve dhe këshilltarëve vendorë



4. PËRFUNDIME

nivelesh të ndryshme, si vendor, rajonal dhe kombëtar. Për më tepër, pranohet në përgjithësi lidhja mes nivelit të angazhimit politik dhe cilësisë së qeverisjes, thellësisë së njohurive të publikut, të kuptuarit dhe familjaritetit, si dhe kontaktit me politikanët dhe që të gjithë këta faktorë luajnë rolin e tyre në ndërtimin e angazhimit në politikë dhe në proceset politike. I modeluar sipas një kërkimi të ngjashëm në Britaninë e Madhe, ky kërkim synon të ofrojë një “kontroll të shëndetit” për shoqërinë, në nivel individual dhe kolektiv dhe përbën kontributin e parë në këtë fushë në Shqipëri.

- Ky kërkim konfirmon se politika dhe proceset politike janë një aktivitet për vetëm gjysmën e pjesëmarrësve, të cilët raportuan se janë të interesuar për këto çështje.
- Ndërkohë që pjesëmarrësit kanë treguar se kanë mjaftueshëm njohuri për politikën në përgjithësi në Shqipëri, shpeshherë njohuritë e thelluara për institucionet dhe proceset politike perceptohen si të pamjaftueshme.
- Pak pjesëmarrës ishin të përfshirë në parti politike si për t’i kujtuar qarqeve politikë se vetëm një fraksion i vogël i popullatës janë aktualisht aktivë në politikë, përtej votimit.
- Me përjashtim të pjesëmarrjes në votime, ky studim tregon se angazhimi politik i qytetarëve dominohet nga forma informale të angazhimit.
- Ka një perceptim të gabuar në lidhje me konceptin e angazhimit politik, ku thuajse gjysma e pjesëmarrësve e lidhin vetëm me angazhimin në një parti politike. Ky perceptim i gabuar mund të kontribuojë në rënie të interesit për politikën dhe në rënie të angazhimit, pasi politika perceptohet si e distancuar nga qytetarët e zakonshëm dhe e bërë nga të tjerët dhe për të tjerët.
- Sigurisht, politika është shumë më e gjerë se parlament dhe, me mbështetjen e këtij studimi, ka një të vërtetë në shprehjen se “çdo politikë është lokale”.⁴⁷ Përfshirja në vendimmarrjen vendore shkon dorë më dorë me prirjen për të votuar. Për më shumë, shumica e veprimeve që pjesëmarrësit kanë ndërmarrë për të ndryshuar një situatë më të cilën ishin të pakënaqur kanë qenë të një karakteri vendor.
- Pjesëmarrësit qëndrojnë të interesuar dhe gati për t’u përfshirë dhe për të vepruar në lidhje me çështje që ndikojnë mbi ata vetë, familjet e tyre dhe komunitetet. Ata thonë qartë se duan që t’i dëgjohet zëri për një përfshirje më kuptimplote, veçanërisht në nivel vendor.
- Është inkurajues fakti se gjysma e pjesëmarrësve do të ishin të gatshëm të merrnin pjesë në aktivitete të organizuara nga qytetarët ose grupe të shoqërisë civile, për të ushtruar presion. Megjithatë, shoqëria civile pritet të jetë më aktive për të arritur deri tek qytetarët, për të kuptuar më mirë nevojat e tyre duke i ofruar platforma konkrete për diskutim.

⁴⁷ O’Neill, T. (1994). All politics is local. Adams Media Corporation: USA

- Pjesëmarrësit kishin bindje të ndryshme në lidhje me votimin elektronik, votën boshë apo votën që 16 vjeç dhe rritjen e pjesëmarrjes në votime.
- Gjetjet e studimi tregojnë se pjesëmarrësit presin nga qeveria, parlament dhe opozita që të jenë më shumë të orientuar nga qytetarët. Ashtu si në studime të ngjashme pakënaqësia e pjesëmarrësve për të tre institucionet ishte më shumë se 50%.
- Perceptimet e efikasitetit dhe pushtetit varionin sipas niveleve vendore dhe kombëtare. Pjesëmarrësit ndihen më të pashpresë në nivel kombëtar, gjë që tregon se institucionet qendrore perceptohen si më të distancuara nga pjesëmarrësit. Megjithatë, ato raportojnë se ndihen të pashpresë edhe në nivel vendor, gjë që është dekurajuese dhe shqetësuese.
- Edhe pse pjesëmarrësit e shohin Parlamentin si institucionin thelbësor për demokracinë, ata presin që ky institucion të kryejë funksionet bazë të përfaqësimit, kontrollit/monitorimit dhe ligjvënies.
- Perceptimet e pjesëmarrësve për deputetët nuk janë inkurajuese. Ata presin që deputetët të adresojnë më mirë interesat e tyre ose të familjeve të tyre, të punojnë më shumë në mënyrë etike dhe të jenë më transparentë. Po ashtu, ata shprehën qartë nevojën për kontakte të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e zgjedhur në nivel vendor dhe qendror.

5. REFERENCAT

- Albanian Coalition for Promotion of Women and Youth in Politics (29 Maj 2015). Public Statement: Albania among the last countries in Europe for women running for local public office. E marrë nga <http://www.crca.al/news-statements-women-and-youth-politics-women-politics/public-statement-albania-among-last> e aksesuar në tetor 2015.
- Albanian Helsinki Committee (2015). Main Findings of the Monitoring of the Preparatory Process for the Local Elections of June 21, 2015. Tirana.
- Ashiku, M. (2014). Institutions, Economic Development and Social Capital in Albania. *Journal of Economics and Development Studies*, 2 (2): fq. 469 - 481
- Bhatti, Y. dhe Hansen K.M. (2010). How Turnout Will Decline as the Western Population Grows Older Paper presented at the ECPR Joint Sessions of Workshops, Münster, Germany.
- Chan, T.W. dhe Clayton, M. (2006). Should the voting age be lowered to sixteen? Normative and empirical considerations. *Political Studies*, 54. pp. 533–558
- Coalition for free and fair elections and sustainable democracy (2015). Preliminary statement on local elections 2015. E marrë nga http://www.kzln.org.al/docs/KZLNDQ_Deklarate_Paraprake_Zgjedhje_Vendore_2015_%2022qershor.pdf e aksesuar në tetor 2015
- Croke, K., Grossman, G., Larreguy, H. & Marshall, J. (2015). Deliberate disengagement: how education decreases political participation in electoral authoritarian regimes. *Afrobarometer*.
- Cunningham, M. Flinders, M. (2015). *Participatory Arts and Political Engagement*. Arts and Humanities Research Council.
- Dahl, R. A. (2000). *On democracy*. Yale University Press
- Dauti, M (2013). *How Institutions Matter for Local Development: Evidence from the Implementation of Decentralization Reform in Albania*. Arts & Sciences Electronic Theses and Dissertations. Paper 273. E marrë nga
- Delli Carpini, M. X. (2004). *Mediating Democratic Engagement: The Impact of Communications on Citizens' Involvement in Political and Civic Life*. In *Handbook of Political Communication Research*, ed. Lynda Lee Kaid. Mahwah, NJ: LE Publishers
- Dhembo, E., Duci, V. and Ajdini, J. (2016). "Why do I have to trust you?" The perspective from civil society on active citizenship in post-communist Albania. *Croatian International Relations Review*, 21 (73).
- Ekman, J. & Amna, E. (2012). Political participation and civic engagement: towards a new typology. *Human Affairs* 22, 283–300, DOI: 10.2478/s13374-012-0024-1
- European Commission (2014). *Public opinion in the European Union*. Standard

- Eurobarometer 82, Autumn 2014. E marrë nga http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/eb/eb82/eb82_publ_en.pdf e aksesuar në tetor 2015
- European Union, Treaty of Lisbon Amending the Treaty on European Union and the Treaty Establishing the European Community, 13 December 2007, 2007/C 306/01. E marrë nga <http://www.refworld.org/docid/476258d32.html> e aksesuar në tetor 2015
 - Flinders, M. (2012). Debating Demonization: In Defence of Politics, Politicians and Political Science. *Contemporary Politics*. 18 (3), fq. 355-366.
 - Flinders, M. (2015). Political Fall-Out. Fewer People than Ever are Planning to Vote in the Forthcoming General Election. What is Turning off the Electorate? *Society Now-ESRC Research Making an Impact*. 21, fq. 12-13.
 - Fox, S. (2014). Is it Time to Update the Definition of Political Participation? Review of "Political Participation in Britain: The Decline and Review of Civil Culture. *Parliamentary Affairs*. 67, fq. 495-505
 - Fraenkel-Haeberle, C., Kropp, S., Palermo, F. and Sommermann, K. P. (2015). Citizen Participation in Multi-level Democracies. Boston: Brill-Nijhoff, fq. 11.
 - Franklin, M. N. (1996). Electoral Engineering and Cross National Turnout Differences. *British Journal of Political Science*. 29 (1), fq. 205-216
 - Galston, W.A. (2001). Political knowledge, political engagement and civic education. *Annual Review of Political Sciences*, 4: 217-234.
 - Hansard Society (2015). Audit of political engagement 12: the 2015 report. London, UK: Ruth Fox and Joel Blackwell
 - http://openscholarship.wustl.edu/art_sci_etds/273 e aksesuar në prill 2016
 - http://www.osfa.al/sites/default/files/survey_full_report_0.pdf e aksesuar në mars 2015.
 - IDM (2010). An action agenda for civil society. E marrë nga <https://civilsocietyindex.files.wordpress.com/2010/09/dokument-politikash-indeksi-i-shoqerise-civile-shqiperine.pdf> e aksesuar në prill 2016.
 - IDM (2015). Trust in government. E marrë nga http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/02/Raporti-i-plote_-sondazhi_besimi-ne-qeveri_2015.pdf e aksesuar në prill 2016.
 - IFES Election Guide (2013). Albania Parliamentary elections 2013. E marrë nga http://www.electionguide.org/elections/id/1664/http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/eb/eb82/eb82_publ_en.pdf e aksesuar në tetor 2015.
 - Institute for Democracy and Mediation (IDM) (2011). CIVICUS: Civil Society Index for Albania in search of citizens and impact. Albania: Gjergji Vurmo.
 - Institute for Democracy and Mediation (IDM) (2015). Index of integrity of the June 21, 2015 local elections in Albania. Tirana, Albania
 - Institute of Democracy and Mediation (IDM) (2014). Albanians and the European Social Model, Public Administration in Albania: between politics and citizens. Tirana: Elona Dhëmbo fq.11
 - Institute of Democracy and Mediation (IDM) (2014). Challenges of democracy at local level: An Analytical Overview of the Draft Law "On Some Additions and Amendments to Law No. 8652, dated 31.07.2000, 'On Organization and Functioning of Local Governance", Policy paper nr 5, November 2014.
 - Internet voting is just too hackable, say security experts. USA TODAY. E marrë nga <http://www.usatoday.com/story/tech/news/2016/01/28/internet-voting-not-ready-prime-time-security-risks/79456776/> e aksesuar në mars 2016.
 - Kacidhja, E. (2013). Civil society and interest groups involvement in the legislative process. In Institute for Democracy and Mediation (2013). Parliamentary challenges in the EU accession process. Tirana, Albania fq: 8 – 19.
 - Lewis-Beck, M.S., Jacoby, W., Norpoth, H.

- dhe Weisberg, H. F. (2008). *The American Voter Revisited*. Ann Arbor: University of Michigan Press.
- Ligji nr. 8788, dt. 07.05.2001 “Për organizatat jo-fitimprurëse”
 - Lipcsei, R., Bruce, B. & Vinodrai, T. (2015). *Evolving the competitive edge: rural community engagement*. Economic Developers Council of Ontario (EDCO). E marrë nga <http://events.tamarackcommunity.org/latest/community-engagement-in-rural-areas> e aksesuar në mars 2016.
 - Lippman, W. (1960). *Public opinion*. New York: McMillan
 - National Democratic Institute (2015). *Focus group research report: findings from public opinion research in Albania*. Tirana, Albania.
 - Norris, P. (2000). *A virtuous circle: Political communications in post - industrial societies*. New York: Cambridge University Press
 - OECD (2015). *Better life index: civic engagement*. E marrë nga <http://www.oecdbetterlifeindex.org/topics/civic-engagement/> e aksesuar në mars 2016.
 - Open Society Foundation in Albania (2014). *National survey on perceptions & expectations towards a potential EU membership of Albania*, e marrë nga
 - OSCE (2015). *Report to the permanent council by the head of the presence in Albania*. E marrë nga <http://shqiptarja.com/pdf/new/OSBE.pdf> e aksesuar në tetor 2015.
 - OSCE/ODIHR Election Observation Mission (2015). *Final Report on 2015 Local Elections*. E marrë nga <http://www.osce.org/albania> e aksesuar në prill 2015.
 - Otvoreni Parliament (2015). *Audit of political engagement 2015: Public opinion poll on citizen participation in democratic processes in Serbia*. E marrë nga <http://www.otvoreniparlament.rs/wp-content/uploads/2015/09/Audit-of-political-engagment-in-Serbia-2015.pdf> e aksesuar në prill 2016.
 - Partners Albania, Center for Change and Conflict Management (2013). *Participation of citizens and civil society in democracy: study on the legal and regulatory framework and practice in Albania*. Tirana: Arjola Agolli, Besjana Guga dhe Elona Kapexhiu.
 - Persson, M. (2015). *Education and political participation*. *British Journal of Political Science*. 45 (3), fq: 689-703
 - United Nations Development Program (2015). *Research on voter education and motivation prior to June 2015 local elections in Albania*. Tirana: Partners Albania
 - Verba, S. , Schlozman, K.L. and Brady, H. (1995). *Voice and Equality: Civic Voluntarism in American Politics*. Cambridge, Mass.: Harvard University Press.

6. SHTOJCAT

A. Rishikimi i literaturës

Konteksti i angazhimit politik në Shqipëri

Gjatë regjimit komunist shqiptarët kanë krijuar qëndrime pasive dhe neutrale ndaj angazhimit publik dhe civil, të cilat mbarten dhe në demokracinë e sotme. Në ditët e sotme, rezultati më i ulët i shoqërisë civile në Shqipëri është në angazhimin politik. Shumë shqiptarë kanë “nivele të larta të indiferencës” dhe “apati të përhapur” kur është fjala për veprimin në sferën publike.⁴⁸ Në përgjithësi, në shoqëritë post-industriale qytetarët bëhen gjithmonë e më pak të angazhuar nga kanalet tradicionale të pjesëmarrjes politike (Dalton 2006).⁴⁹ Një shenjë e dukshme e dëmit të nervit të pjesëmarrjes civile është interesi në rënie dhe pjesëmarrja e ulët në çështjet publike, individualizmi, kujdesi vetëm për çështje personale dhe neglizhimi i atyre çështjeve që kanë natyrë publike.⁵⁰

Ndërkohë që në vitin 2015 pjesëmarrja në votime ishte e ulët në krahasim me zgjedhjet vendore të vitit 2011, gjithsesi është herët për të arritur në përfundimin nëse kjo është një shenjë e uljes së pjesëmarrjes në votime. Megjithatë, angazhimi politik në Shqipëri

shkon përtej pjesëmarrjes në votime, sikundër në vende të tjera. Për shembull, studimet e opinionit publik tregojnë se shqiptarët janë shumë të interesuar për politikën.⁵¹ Studime të tjera në këtë fushë tregojnë se pjesëmarrja politike dhe aktivizmi në Shqipëri, pavarësisht zhvillimeve në periudhën post-komuniste, kanë qenë vazhdimisht të ulëta. Me shumë pak përjashtime, siç ka qenë për shembull angazhimi i qytetarëve për të ushtruar presion në qeveri për t'i thënë “jo” shkatërrimit të armëve kimike në Shqipëri, ka shumë pak përvoja pozitive.⁵²

Aktualisht, Shqipëria gëzon statusin e kandidatit në BE (që nga 24 qershori 2014), një arritje që erdhi pas përpjekje të vazhdueshme për të zbatuar dhe konsoliduar reformat që lidhen me BE, veçanërisht ato që lidheshin me statusin aq të dëshiruar. Ky është një hap kyç për një shtet që ende përballet me çështje të korrupsionit dhe krimit.

Faktorë të ndryshëm si gjinia, mosha, arsimi dhe vendbanimi (rural ose urban) ndikojnë në nivelin e angazhimit politik në Shqipëri. Studime të fundit rekomandojnë se shoqëria civile duhet të jetë më shumë e pranishme në zonat rurale për të mbështetur qytetarët në krijimin e një komuniteti aktiv, duke qenë se këto zona kanë qenë ndër më të margjinalizuarat dhe të izoluarat në axhendën

48 Institute for Democracy and Mediation (2011). CIVICUS: Civil Society Index for Albania in search of citizens and impact. Albania: Gjergji Vurmo

49 Po aty.

50 Ashiku, M. (2014). Institutions, Economic Development and Social Capital in Albania. *Journal of Economics and Development Studies*, 2 (2): fq. 469 - 481

51 European Commission (2014). Public opinion in the European Union. Standard Eurobarometer 82, Autumn 2014. E marrë nga http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/eb/eb82/eb82_publ_en.pdf e aksesuar në tetor 2015

52 Dhembo, E., Duci, V. Dhe Ajdini, J. (2016). “Why do I have to trust you?” The perspective from civil society on active citizenship in post-communist Albania. *Croatian International Relations Review*, 21 (73).

e organizatave të shoqërisë civile (OSHC), ku deri në 70% të OSHC-ve nuk i kanë përfshirë ato në programet e tyre).⁵³ Për sa i përket gjinisë, janë ndërmarrë një sërë nismash për të rritur pjesëmarrjen e grave në çështjet publike. Megjithatë, pjesëmarrja e vërtetë vazhdon të jetë e ulët për shkak të ndarjes së punës dhe të detyrimeve në komunitet sipas ndarjes gjinore, si dhe për shkak të paragjykimëve të forta që shoqërojnë aktivizmin e grave, sidomos në zonat rurale.⁵⁴ Një studim i fundit i opinionit publik tregoi se pjesëmarrja politike priret të ulet me rritjen në moshë.⁵⁵ Arsimi shpesh lidhet me rritjen e informimit politik dhe të pjesëmarrjes.

Informimi politik

Literatura sugjeron se nivelet e njohurive politike ndikojnë në pranimin e parimeve demokratike dhe qëndrimeve ndaj çështjeve publike dhe pjesëmarrjes politike.⁵⁶ Sipas Eurobarometer (2014), një pjesë e madhe e publikut në Shqipëri (74%) është shumë i interesuar për çështjet politike në nivel vendor, kombëtar dhe evropian dhe thuhet gjysma e tyre besojnë qeverinë aktuale.⁵⁷ Nga viti 2011, Shqipëria është bërë pjesë e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur, për të promovuar demokracinë e mirë dhe pjesëmarrëse dhe për të nxitur zhvillimet sociale dhe ekonomike. Megjithatë, në praktikë ka pak dëshirë dhe gatishmëri për ta vënë në zbatim.⁵⁸

Nga ana tjetër, raportet e zgjedhjeve vendore

53 IDM (2010). An action agenda for civil society. E marrë nga <https://civilsocietyindex.files.wordpress.com/2010/09/dokument-politikash-indeksi-i-shoqerise-civile-shqiperine.pdf> e aksesuar në prill 2016.

54 Dhembo, E., Duci, V. and Ajdini, J. (2016). "Why do I have to trust you?" The perspective from civil society on active citizenship in post-communist Albania. *Croatian International Relations Review*, 21 (73).

55 IDM (2015). Besimi tek qeveria. E marrë nga http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/02/Raporti-i-plote_-sondazhi_besimi-ne-qeveri_2015.pdf e aksesuar në prill 2015

56 Galston, W.A. (2001). Political Knowledge, Political Engagement and Civic Education. *Annual Review of Political Sciences*, 4: 217 – 234.

57 European Commission (2014). Public opinion in the European Union. Standard Eurobarometer 82, Autumn 2014. E marrë nga http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/eb/eb82/eb82_publ_en.pdf e aksesuar në 10 tetor 2015

58 Institute of Democracy and Mediation (2014). *Albanians and the European Social Model, Public Administration in Albania: between politics and citizens*. Tirana: Elona Dhëmba fq.11

të vitit 2015 tregojnë se informimi publik për kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiakë ishte shumë i ulët.⁵⁹ Në përputhje me këto rezultate, një raport i PNUD-it i realizuar para zgjedhjeve të 2015 tregon se qytetarët ishin të ndërgjegjshëm përgjithësisht për faktet bazë, si: ka zgjedhje më 21 qershor për organet e qeverisjes vendore, votimet do të jenë për kryetarin e bashkisë dhe për këshillin bashkiak dhe ka një riorganizim të territorit të bashkive. Megjithatë, pjesëmarrësit në sondazh kishin pak njohuri si për kryetarin ashtu dhe për kandidatët për këshillat bashkiakë. Shpesh qytetarët nuk e kishin këtë informacion një ditë para zgjedhjeve. Gjithashtu, ata nuk kishin pothuajse aspak njohuri për çështje më të zgjeruara zgjedhore ose civile në lidhje me këshillat bashkiakë, si p.sh., si zgjidhet këshilli, sa anëtarë ka këshilli, sa zgjat mandati i këshilltarit, funksionet e bashkisë, etj.⁶⁰

Pjesëmarrja politike

Pjesëmarrja publike në qeverisje, arritja e praktikave të mira për qeverisjen duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit, informimit dhe konsultimit si dhe rritja e transparencës në procesin e hartimit të politikave me ndikim social janë kritike për një vend si Shqipëria, e cila lufton që të përmbushë atë që në teorinë aktuale të shtetit konsiderohet si sfida më e madhe e demokracisë: tranzicioni nga demokracia përfaqësuese në një demokraci pjesëmarrëse.⁶¹

Ligji nr. 8652, data 31.07.2000, "Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore", është ligji që duhet të parashikojë standardet minimale për konsultimin dhe procedurat përkatëse. Megjithatë, ligji ka mungesë konceptuale në ndarjen mes konsultimit, informimit dhe shkëmbimit si dhe

59 Koalicioni për zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe demokracinë e qëndrueshme (2015). Deklaratë paraprake për zgjedhjet vendore 2015. E marrë nga http://www.kzln.org.al/docs/KZLNDQ_Deklarate_Paraprake_Zgjedhje_Vendore_2015_%2022qershor.pdf E aksesuar në 6 tetor 2015

60 United Nations Development Program (2015). *Research on Voter Education and Motivation prior to June 2015 Local Elections in Albania*. Tirana: Partners Albania

61 Kacidhja, E. (2013). Civil Society and Interest Groups Involvement in the Legislative Process. In Institute for Democracy and Mediation (2013). *Parliamentary Challenges in the EU Accession Process*. Tirana, Albania pp: 8-9.

të procedurave dhe standardeve minimale të konsultimit. Amendamentet e ligjit nuk parashikojnë asnjë risi në lidhje me strukturat që mbështesin pjesëmarrjen e qytetarëve (struktura ndërlidhëse), të cilat janë kryetari i fshatit dhe kryeplaku në zonat rurale, si dhe administratorët e lagjeve në qytete.⁶² Megjithatë, hapa pozitivë janë ndërmarrë në lidhje me legjislacionin. Ligjet e reja për konsultimin publik dhe lirinë e informimit janë hapa përpara për një demokraci më transparente dhe pjesëmarrëse.⁶³ OSHC kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndryshimin e ligjit.

Sipas studimit të “Besimit në qeveri” të vitit 2015, edhe pse qytetarët mendojnë se kanë mjaftueshëm informacion për të gjykuar nëse një vendim specifik është i mirë apo i keq, ata vazhdojnë të besojnë se vetëm deputetët duhet të marrin përgjegjësinë për të hartuar politika publike (80%). Këto gjetje tregojnë për një apati të përgjithshme të shoqërisë.⁶⁴ Këto prirje janë gjithashtu të rëndësishme për rolin e perceptuar të qytetarëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Motivimi i qytetarëve për të monitoruar punën e deputetëve është një element kyç për t’i kërkuar llogari atyre dhe institucioneve përkatëse. Arsyet kryesore për këtë shpjegohen dhe në studime të tjera: perceptimi se politika është një “biznes i pisët”, risku i humbjes së vendit të punës me rotacionin e forcës politike; gratë pjesëmarrëse përmendin më shumë mungesën e kohës, ngarkesën e detyrimeve të shumta familjare dhe pritshmëritë shoqërore si dhe perceptimin e politikës si punë për burrat, arsimin dhe shprehjet. Angazhimi civil ka të njëjtin model; pra, qëndron në nivele të ulëta dhe shoqëria civile nuk është shumë e njohur në publik.⁶⁵

Në lidhje me pjesëmarrjen në votime, pjesëmarrja e grave konsiderohet pozitive. Gratë në Parlament shihen si produktive dhe performanca e tyre më pozitive se ajo e

burrave kolegë. Gratë politikane perceptohen më pozitivisht në nxitjen e dialogut mes partive dhe më të afta për të bërë diskutime konstruktive sesa burrat kolegët e tyre.⁶⁶ Megjithatë, vetëm 11% e kandidatëve për kryetarë bashkie ishin gra dhe vajza në zgjedhjet vendore të vitin 2015. Në përputhje me këtë janë rezultatet e pjesëmarrjes së të rinjve, me vetëm 6% kandidatë të rinj për kryetarë bashkie në zgjedhjet vendore të vitit 2015.⁶⁷

Parlamenti dhe publiku

Studime të fundit nxjerrin në pah se publiku nuk e konsideron Parlamentin si institucion të hapur dhe tregon pak interes për të marrë informacione prej tij.⁶⁸ Aktualisht, publiku mbështetet tek media si burim informacion për punën e Parlamentit. Për më tepër, evidentohet një nivel i ulët i interesit për të ndjekur diskutimet parlamentare për shkak të mungesës së kulturës së dialogut mes deputetëve dhe ndjesia e zhgënjimit nga politika dhe politikanët. Gjithashtu, shumica e njerëzve mendojnë se është e vështirë të takosh një deputet. Shumë vetë nuk dinë se si të kontaktojnë deputetin që përfaqëson zonën e tyre.⁶⁹

Pavarësisht faktit se gjatë 2015 është bërë progres për funksionimin e Parlamentit, veçanërisht duke përmirësuar transparencën e ligjvënies,⁷⁰ ende vlen të shqyrtohet nëse këto ndryshime kanë pasur ndikim në perceptimet e qytetarëve për Parlamentin. Raporti i progresit i BE-së për Shqipërinë deklaroi se duhet të rritet bashkërendimi me pjesën e ekzekutivit, së bashku me mekanizma të tjerë monitorimi, siç janë interpelancat.⁷¹

66 Po aty.

67 Albanian Coalition for Promotion of Women and Youth in Politics (29 May 2015). Public Statement: Albania among the last countries in Europe for women running for local public office. E marrë nga <http://www.crca.al/news-statements-women-and-youth-politics-women-politics/public-statement-albania-among-> e aksesuar në tetor 2015.

68 National Democratic Institute (NDI) (2015). *Focus Group Research Report: Findings from Public Opinion Research in Albania*. Tirana, Albania

69 Po aty.

70 EU (2015). Albania 2015 Progress Report. E marrë nga http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf, e aksesuar në prill 2016

71 Ibid.

62 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2014). Sfidat e demokracisë në nivel vendor: Pamje analitike e projektligjit “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000, ‘Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore’”, Dokument Politikash nr. 5, nëntor 2014

63 Ligji nr. 119/2014 “Mbi të drejtën e informimit” dhe Ligji nr. 146/2014 “Mbi lajmërimin dhe konsultimin publik”

64 IDM (2015). *Besimi në qeveri*. Tirana: Lame dhe Papa, fq.6

65 National Democratic Institute (NDI) (2015). *Focus Group Research Report: Findings from Public Opinion Research in Albania*. Tirana, Albania

B. Metodologjia e detajuar

Hartimi i studimit

Për qëllimet e këtij studimi është përdorur metodologjia mikse. Për pjesën sasiore është përdorur kampioni me shtresa duke vendosur kuota, bazuar në kritere të parapërcaktuara, atë të gjinisë dhe të zonës rurale/urbane. Studimi është realizuar në 12 zona të ndryshme të Shqipërisë, të ndara në 24 zona rurale dhe urbane (shih Shtojcën C me zonat e studimit). Edhe pse mbulimi gjeografik i studimit është kombëtar, duhet marrë parasysh se nuk është përdorur një kampion rastësor, të dhënat nuk mund të përgjithësohen në të gjithë popullatën. Ato tregojnë prirjet e pjesëmarrësve të këtij studimi.

Pjesa cilësore e studimit kishte dy funksione:

- Faza para sondazhit: janë realizuar intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të partive politike dhe ekspertë të shoqërisë civile (përfshirë akademikë) në mënyrë që të plotësohej hartëzimi i “nevojave dhe shqetësimeve” nga një perspektivë praktike. U realizua edhe një diskutim në fokus grup për të vleftësuar dimensionet dhe treguesit e identifikuar si dhe për të përfshirë më shumë aspekte vendore të angazhimit politik.
- Fokus grupe pas sondazhit dhe takim me ekspertët: janë organizuar tre fokus grupe me përfaqësues nga publiku dhe një me ekspertë për të eksploruar mendimet dhe perceptimet e tyre për temën e kërkimit dhe gjetjet e sondazhit.

Kampionimi

Për pjesën sasiore, kuadri i kampionit përfshinte individët mbi moshën 18 vjeç dhe të aftë për të votuar.⁷² Kampioni përfundimtar konsistonte në N = 1538 pjesëmarrës. Një kampion i tillë ofronte një nivel më të lartë

saktësie në sondazh. Kampioni i përzgjedhur ishte ai i shtresëzuar dhe përfaqësues duke marrë parasysh mungesën e një kuadri të saktë të kampionimi në Shqipëri për shkak të lëvizshmërisë së popullatës, mungesën e një sistemi adresash dhe faktin se listat më të sakta të zgjedhësve vazhdojnë të jenë të fryra për shkak të emigrantëve dhe njerëzve që nuk jetojnë në Shqipëri. Për më tepër, kjo metodë është më e konsoliduar dhe e përdorur në studime të ngjashme në vend dhe më gjerë. Kriteret e parapërcaktuara për shtresat ishin gjinia dhe zona rurale dhe urbane. Në mënyrë specifike, kampioni u nda në 12 zona të Shqipërisë, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:⁷³

1. U përzgjedh qendra e rajonit, kështu që studimi u përqendrua në një bashki.
2. Brenda bashkisë janë përzgjedhur dy zona, një rurale dhe një urbane (50/50), kryesisht fshati më i madh⁷⁴ (në total ishin 24 njësi, dhe kishte nga 64 pjesëmarrës për njësi).
3. U përzgjedh një numër i barabartë i burrave dhe grave (32/32 për secilën njësi);⁷⁵
4. Intervistuesit kanë përdorur një kampionim aksidental për individët dhe janë udhëzuar që të jenë të vëmendshëm në mënyrë që të përfshijnë sa më shumë që të jetë e mundur pjesëmarrës të grupeve të ndryshme moshore.

Për pjesën cilësore para-sondazhit është përzgjedhur kampioni i qëllimshëm me përfaqësues të partive politike dhe të shoqërisë civile. Fokus grupi i parë ka përfshirë pjesëmarrës nga shtresa të ndryshme sociale dhe ekonomike, me moshë dhe nivel të ndryshëm arsimor. Për pjesën cilësore pas sondazhit pjesëmarrësit në fokus grup u përzgjedhën duke marrë në konsideratë gjetjet e studimit në lidhje me variabla demografike specifike, në mënyrë që të shqyrtohen më shumë perspektiva të ndryshme për angazhimin politik. Në këtë mënyrë, diskutimet në fokus grup përfshinë pjesëmarrës të zonave urbane ose rurale, me nivele të ndryshme arsimore (të ndara në arsim të lartë dhe të ulët/mesëm), burra dhe

⁷² Edhe pse angazhimi politik i pjesëmarrësve më të rinj, p.sh. në moshën 14 deri në 18 vjeç ose dhe më rinj, është gjithashtu shumë i rëndësishëm, duhen instrumente të tjerë të përshtatshëm për moshën për të matur perceptimet e tyre, diçka që nuk ishte e mundur për këtë studim. Megjithatë, sugjerohet që për kërkime të mëtejshme të përfshihet dhe kjo grupmoshë.

⁷³ Informacion më i detajuar gjendet në Shtojcën C.

⁷⁴ Censusi i fundit në Shqipëri tregoi se ka një popullatë të barabartë rural edhe urbane.

⁷⁵ Bazuar në të njëjtën logjikë të Censurit, sipas të cilit ka një numër të barabartë të burrave dhe grave në Shqipëri .

gra dhe me status të ndryshëm punësimi. Megjithatë, në mënyrë që të rritet pjesëmarrja dhe shprehja e mendimeve në çdo fokus grup u përdor një tipologji e caktuar dhe fokus grupet ishin si më poshtë:

- Tek i pari ishin nga zonat rurale,
- Tek i dyti të gjithë ishin me arsim të lartë,
- Tek i treti shumica ishin me arsim të ulët ose të mesëm

Në vazhdim të qëllimit të vleftësimit të gjetjeve është realizuar dhe një fokus grup me ekspertët për t'i shërbyer analizës dhe interpretimit të të dhënave. Pjesëmarrësit ekspertë ishin përfaqësues të shoqërisë civile dhe akademikë.

Në mënyrë të përmbledhur kampioni i studimit shihet në tabelat e mëposhtme

Kampionimi sasior

Tabela 2. Kampioni i sondazhit të studimit

Zona/ Kategoria	Gra	Burra
Urbane	401	414
Rurale	355	367
Gjithsej	756	781*)

*) Edhe pse në kampionin përfundimtar kishte një ndryshim të vogël mes gjinive, ky ndryshim nuk ka ndikuar në raportin dhe analizën e të dhënave.

Kampionimi cilësor

Tabela 3. Qualitative sample

	Intervista gjysmë të strukturuar	Fokus grupe para sondazhit	Fokus grupe pas sondazhit
Numri i pjesëmarrësve	8	9	32

Instrumentet kërkimore

Instrumentet kërkimore të përdorur për këtë studim janë hartuar nga hulumtuesit duke u bazuar në praktikën dhe sugjerimet e ekspertëve të Hansard Society si dhe në bashkëpunim dhe me sugjerimet e Institutit Demokratik Amerikan (NDI) në Shqipëri. Për

pjesën sasiore u përdor një pyetësor me pyetje të mbyllura, që ishte ndarë në 5 seksione të ndryshme: seksioni demografik, perceptimet për Parlamentin dhe përfaqësuesit e zgjedhur, angazhimi politik dhe pjesëmarrja në nivel qendror ose vendor, njohuritë politike dhe interesi, si dhe efikasiteti dhe kënaqësia. Pyetësori u bazua fillimisht në pyetësorin origjinal të "Analizimit të Angazhimit Politik", por u përshtat për Shqipërinë. Pyetësori i parë u pilotua në zona rurale dhe urbane në një total me N = 200 pjesëmarrës dhe më pas u bënë ndryshimet e nevojshme, për sa i përket thjeshtëzimi të gjuhës dhe përmbajtjes/gjatësisë së pyetësorit. Versioni final i pyetësorit u konsultua sërish me ekspertët e fushës përpara dhe pas fazës së pilotimit (Shih Shtojcën D: Pyetësori i studimit).

Për pjesën cilësore janë zhvilluar tre instrumente: një intervistë gjysmë e strukturuar për aktorët kyç dhe dy udhëzues për fokus grupet, një për pjesën para sondazhit dhe një për pjesën pas sondazhit. Instrumentet cilësore nuk lidhen me studimin origjinal dhe metodologjinë e Shoqërisë Hansard, por shërbejnë për qëllime të përshtatjes dhe kontekstualizimit të pyetësorit (para sondazhit) dhe për të kuptuar më mirë gjetjet sasiore (pas sondazhit).

Sasior

- Pyetësori "Analiza e angazhimit politik"

Cilësor

- Intervistë gjysmë e strukturuar me aktorët kyç
- Para sondazhit, udhëzues për diskutimet në fokus grup
- Pas sondazhit, udhëzues për diskutimet në fokus grup

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Pyetësori është hartuar fillimisht në anglisht dhe është përkthyer dhe vleftësuar në shqip. Një pjesë e rëndësishme e procesit ishte konsultimi i vazhdueshëm dhe i kujdesshëm me ekspertët. Intervistuesit e terrenit u trajnuan për administrimin e pyetësorit. Kërkuesit kanë realizuar vetë intervistat gjysmë të strukturuar me ekspertët kyç dhe

fokus grupet. Administrimi i pyetësorit ka zgjatur tre javë në muajin shkurtit të vitit 2016 (8 me 26 shkurt).

Të dhënat sasiore u analizuan duke përdorur programin SPSS 20. Të dhënat u kontrolluan për vlera që mungonin ose ekstreme dhe u pastruan. Më pas, janë përdorur frekuencat dhe kryqëzimi i të dhënave si teste kryesore të studimit.

Për analizën e të dhënave cilësore është përdorur përfaqësja tematike. Përmbledhja e analizës së të dhënave kaloi nga një rishikim i pavarur, dytësor pas së cilit ekipi i kërkimit ka zgjidhur mospërputhje të vogla gjatë takimeve të ekipit kërkimor.

Konsideratat etike

Të gjithë pjesëmarrësit e këtij studimi duhet të jepnin miratimin e tyre të informuar për pjesëmarrjen në studim. Pjesëmarrja ishte vullnetare. Të gjitha të dhënat janë trajtuar në mënyrë konfidenciale dhe janë përdorur vetëm për qëllime të këtij studimi.


Kufizimet e studimit

- Edhe pse kampionimi rastësor mund të ofronte mundësinë për përgjithësimin e të dhënave për të gjithë popullatën, ai nuk ishte i mundur për shkak të kufizimeve kohore dhe financiare.
- Pavarësisht faktit se është bërë përpjekje që në studim të përfshihen të gjithë treguesit përkatës të angazhimit politik sipas modeli të Hansard Society dhe të studimit përkatës, ka dhe faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në angazhimin politik të qytetarëve. Rekomandohet që studimet e mëtejshme që mund të ndërmerren në këtë fushë t'i trajtojnë dhe t'i përfshijnë këta faktorë.

Karakteristikat e pjesëmarrësve


Në total N=1538 pjesëmarrës u bënë pjesë e këtij studimi. Thuajse gjysma prej tyre ishin nga zonat urbane (53%) dhe gjysma tjetër nga ato urbane (47%).

Grafiku 22. Zona e pjesëmarrësve




Sikurse shihet në grafikët e mëposhtëm (Grafikët 23, 24, 25 dhe 26), thuajse gjysma e pjesëmarrësve ishin femra (49.2%) dhe gjysma tjetër ishin meshkuj (50.8%). Shumica prej pjesëmarrësve kishin arsim të mesëm (47.1%) ose të lartë (28.6%) dhe vitet mesatare të shkollimit të tyre ishin m = 12.46. Ata kishin një moshë mesatare prej m = 38.7 vjet. Shumë prej tyre nuk ishin të punësuar për momentin (24.1%), të tjerë ishin të punësuar në sektorin privat (23.2%) ose në atë publik (13.7%). Pjesa tjetër e pjesëmarrësve ishin të vetë-punësuar ose të papunë, apo studentë dhe pensionistë.


Grafiku 23. Gjinia




Grafiku 24. Mosha e pjesëmarrësve



Grafiku 25. Niveli arsimor



Grafiku 26. Statusi i punësimit



C. Zonat e studimit

Tabela 4. Zonat ku është kryer studimi

Vendi	FrekuenCat	Përqindja	% e vlefshme	% e akumuluar
Shkodër	64	4.2	4.2	4.2
Rrethinat	65	4.2	4.2	8.4
Kukës	64	4.2	4.2	12.5
Bicaj	64	4.2	4.2	16.7
Lezhë	64	4.2	4.2	20.9
Shënkoll	64	4.2	4.2	25.0
Peshkopi	64	4.2	4.2	29.2
Maqellarë	64	4.2	4.2	33.4
Durrës	64	4.2	4.2	37.5
Rashbull	65	4.2	4.2	41.7
Tiranë	64	4.2	4.2	45.9
Kashar	64	4.2	4.2	50.1
Elbasan	64	4.2	4.2	54.2
Bradashesh	64	4.2	4.2	58.4
Fier	64	4.2	4.2	62.5
Levan	64	4.2	4.2	66.7
Berat	64	4.2	4.2	70.9
Otllak	64	4.2	4.2	75.0
Korçë	64	4.2	4.2	79.2
Bulgarec Q.	64	4.2	4.2	83.4
Gjirokastër	64	4.2	4.2	87.5
Lunxhëri	64	4.2	4.2	91.7
Vlorë	64	4.2	4.2	95.8
Q. Vlorë	64	4.2	4.2	100.0
Total	1,538	100.0	100.0	

D. Pyetësi i studimit

Analiza e Angazhimit Politik, Shqipëri 2015 Pyetësor

Miratimi i informuar

Përsëritet, më quajmë _____. Unë punoj si intervistues/e për Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), i cila kryen rregullisht sondazhe mbi tema të ndryshme. Do ta vlerësoja shumë nëse do t'i përgjigjeshit disa pyetjeve. Pyetësi është anonim dhe të gjitha të dhënat e mbledhura do të prezantohen vetëm në formë grupi dhe përdoren vetëm për qëllimet e këtij projekti.

Pjesëmarrja juaj në këtë projekt është krejtësisht vullnetare dhe vendimi juaj për të marrë pjesë ose jo nuk do të ndryshojë marrëdhëniet tuaja të ardhshme me IDM. Në qoftë se ju vendosni të merrni pjesë mund të zgjidhni që për ndonjë arsye të mos i përgjigjeni ndonjëherë prej pyetjeve. Nëse ju vendosni të merrni pjesë, jeni gjithashtu të lirë ta ndërprisni plotësimin e pyetësorit në çdo kohë, pa pasoja për ju.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë studim, mund të kontaktoni IDM në info@idmalbania.org

Faleminderit!

Shënim për intervistuesin. Ju lutemi që përpara kryerjes së intervistës, të plotësoni informacionin më poshtë:

Qarku i të Intervistuarit _____

Fshati/Qyteti i të Intervistuarit _____

Çfarë zone është? Rurale Urbane Periurbane Nuk mund ta klasifikoj

SEKSIONI 0: DEMOGRAFIA

001. Gjinia e të intervistuarit: Mashkull Femër

002. Mosha e të intervistuarit _____ (vite)

003. Vitet e përfunduara të arsimit të të intervistuarit (total) _____ (në vite)

004. Niveli më i lartë i arsimit të të intervistuarit (shëno) _____

005. A jeni aktualisht i/e punësuar?

Jo, nuk kam qenë ndonjëherë	<input type="checkbox"/> 1
Jo për momentin	<input type="checkbox"/> 2
Po, i/e punësuar në sektorin privat	<input type="checkbox"/> 3
Po, i/e punësuar në shtet (sektorin publik)	<input type="checkbox"/> 4
Po, i/e vetëpunësuar	<input type="checkbox"/> 5
Student/e	<input type="checkbox"/> 6
Pensionist/e	<input type="checkbox"/> 7
Tjetër, ju lutem specifikojeni _____	<input type="checkbox"/> 8
Refuzoj të përgjigjem	<input type="checkbox"/> 9

006. A jeni anëtar/e i/e ndonjë partie politike në vend?

Po	<input type="checkbox"/> 1
Jo	<input type="checkbox"/> 2
Refuzoj të përgjigjem	<input type="checkbox"/> 3
Nuk e di/ Nuk jam i/e sigurt	<input type="checkbox"/> 99

007. A jeni anëtar/e i/e ndonjë shoqate/organizate në vend (jo domosdoshmërisht OJQ)?

Po	<input type="checkbox"/> 1
Jo	<input type="checkbox"/> 2
Refuzoj të përgjigjem	<input type="checkbox"/> 3
Nuk e di/ Nuk jam i/e sigurt	<input type="checkbox"/> 99

SEKSIONI 1: PERCEPTIMET MBI PARLAMENTIN DHE PËRFAQËSUESIT E ZGJEDHUR

101. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

Parlamenti shqiptar:	Plotësisht dakord 1	Prirë të jem dakord 2	As dakord as jo dakord 3	Prirë të mos jem dakord 4	Nuk jam aspak dakord 5	Nuk e di 99
A. E vendos qeverinë para përgjegjësisë.	1	2	3	4	5	99
B. Inkurajon përfshirjen e qytetarëve në politikë.	1	2	3	4	5	99
C. Është thelbësor për demokracinë tonë.	1	2	3	4	5	99
D. Diskuton, debaton dhe merr vendime për çështje që kanë rëndësi për mua.	1	2	3	4	5	99
E. Përbëhet nga persona që përfaqësojnë në mënyrë të drejtë të gjitha grupet e shoqërisë (duke përfshirë gratë, minoritetet dhe grupe të tjera vulnerable).	1	2	3	4	5	99
F. Është i përbërë nga deputetë që janë përfaqësues të respektuar të shoqërisë, të cilët punojnë në mënyrë etike.	1	2	3	4	5	99
G. Është transparent në mënyrën se si është organizuar dhe funksionon.	1	2	3	4	5	99
H. Është i hapur ndaj qytetarëve, për të ndjekur mbledhjet e komisioneve dhe seancat plenare.	1	2	3	4	5	99

102. Sa mirë i adresojnë deputetët interesat tuaja dhe ato të familjes tuaj?

- Shumë mirë Mirë As mirë, e as keq Jo shumë mirë
 Aspak mirë Nuk e di

103. Çfarë cilësish mendoni se është e rëndësishme të ketë një deputet? (MOS LEXONI PËRGJIGJET, QARKONI TË GJITHA ALTERNATIVAT E MUNDSHME)

- A. Të jetë i sigurt në vetvete dhe autonom/i pavarur;
- B. Të jetë i kualifikuar në fushën që ai ose ajo përfaqëson;
- C. Të jetë i mirë arsimuar;
- D. Të dijë se çdo të thotë të jesh i varfër, të jetë më afër problemeve të popullit;
- E. Të jetë besnik i partisë që ai ose ajo përfaqëson;
- F. Të ketë eksperiencë në biznes;
- G. Të jetë një “fyturë e re” dhe të ketë një vizion/mentalitet të ri;
- H. Të ketë eksperiencë/background në shoqërinë civile
- I. Të ketë eksperiencë/background në fushën akademike
- J. Të jetë i ndershëm dhe i përgjegjshëm
- K. Tjetër _____
- L. Nuk e di

104. Sipas mendimit tuaj, sa mund ta rrisin propozimet e paraqitura më poshtë përgjegjshmërinë e deputetëve dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë ndaj qytetarëve?

	Në një masë të madhe 1	Disi 2	Shumë pak 3	Aspak 4	Nuk e di 5
A. Sigurimi i kushteve në nivel vendor për një kontakt të drejtpërdrejtë me deputetët/anëtarët e këshillave (nëpërmjet zyrave të deputetëve/godinave të bashkisë).	1	2	3	4	5
B. Nëse do të kishte një detyrim për deputetët dhe këshilltarët që t’i japin përgjigje pyetjeve të qytetarëve (me shkresë ose e-mail) brenda një kohe të arsyeshme.	1	2	3	4	5
C. Nëse do të kishte një detyrim për deputetët dhe këshilltarët që të komunikojnë me qytetarët nëpërmjet Facebook-ut, etj	1	2	3	4	5

SEKSIONI 2: ANGAZHIMI DHE PJESËMARRJA POLITIKE (NIVELI VENDOR DHE QENDROR)

201. Sipas mendimit tuaj, angazhim politik në kontekstin shqiptar do të thotë:

- a. Angazhim në parti politike
- b. Të angazhohesh politikisht pa qenë pjesë e një partie politike.
- c. Të dyja
- d. Nuk e di

202. Nëse zgjedhjet e përgjithshme/parlamentare do të zhvilloheshin këtë javë, sa do të ishin gjasat që ju të votoni?

1. Me siguri nuk do të votoja
2. Ndoshta nuk do të votoja
3. I/E pavendosur-Nuk e di nëse do të votoja ose jo
4. Ndoshta do të votoja
5. Me siguri do të votoja
6. Refuzoj të përgjigjem

203. Sa e përshkruajnë qëndrimin tuaj pohimet më poshtë?

	Plotësisht 1	Kryesisht po 2	Po dhe Jo 3	Kryesisht jo 4	Aspak 5
A. "I want to be involved in decisions of authorities at national level"	1	2	3	4	5
B. "I want to be involved in decisions of authorities at local level, where I live"	1	2	3	4	5

204. Gjatë 12 muajve të fundit (SHËNONI TË GJITHA ALTERNATIVAT E MUNDSHME)

	A keni kryer ndonjë prej aktiviteteve të mëposhtme?	Cilat nga nismat më poshtë do të realizonit nëse do t'ju interesonte apo shqetësonte një çështje e caktuar?
A. Kontaktuar një deputet, një ministër ose një zyrtar tjetër të lartë publik, apo një anëtar të nivelit të lartë të një partie politike		
B. Kontaktuar një anëtar të këshillit bashkiak ose zyrtar/punonjës të bashkisë apo kryetarin e Bashkisë.		
C. Marrë pjesë në një takim të këshillit bashkiak apo në një konsultim publik.		
D. Marrë pjesë si vullnetar në një aktivitet në komunitetin tuaj vendor.		
E. Diskutuar mbi politikën/çështjen në fjalë me njerëz të tjerë.		
F. Shprehur opinionin ose diskutuar mbi politikën në Internet dhe/ose rrjete sociale (Facebook, etj.).		
G. Kërkuar informacion nga organet shtetërore (në formë zyrtare p.sh. me letër, me shkresë)		
H. Marrë pjesë aktive në një fushatë, demonstratë ose marshim të partive politike		
I. Marrë pjesë në një fushatë, demonstratë ose marshim civil (jo të organizuar nga partitë politike)		
J. Krijuar ose nënshkruar një peticion në letër ose përmes internetit.		
K. Njoftuar median (gazetë, radio ose televizion) lidhur me ekzistencën e një problemi.		
L. Tjetër, ju lutem specifikojeni _____		
M. Nuk e di		
N. Asnjë nga më lart (Shko tek Pyetja 206)		

205. Pjesa më e madhe e përpjekjeve tuaja të përmendura në pyetjen e mëparshme, ka qenë:

- a. në nivel vendor
- b. në nivel qendror
- c. në të dyja nivelet njësoj
- d. nuk e di

206. Në rastet në të cilat nuk keni vepruar cilat kanë qenë arsyet? (MOS I LEXONI PËRGJIGJET, QARKONI TË GJITHA ALTERNATIVAT E MUNDSHME:

- A) Askush nuk dëgjon se çfarë kam për të thënë
- B) Mendimi im nuk është i rëndësishëm
- C) Politikanët mendojnë vetëm për veten e tyre
- D) Sistemi nuk më lejon të kem ndikim
- E) Nuk më është dhënë mundësia të kem ndonjë ndikim
- F) Nuk jam i/e interesuar të ndikoj në vendimmarrje
- G) Nuk kam kohën e nevojshme (për të ndikuar në vendimmarrje)
- H) Nuk kam informacion të mjaftueshëm
- I) Mënyra se si është organizuar sistemi zgjedhor e bën votën time të parëndësishme
- J) Politikanët nuk duan t'ia dinë për njerëzit si unë
- K) Tjetër, ju lutem specifikojeni _____

207. Sa do të ishit i/e gatshëm/e të angazhoheshit për::

	Në një masë të madhe	Disi	Shumë pak	Aspak	Nuk e di
	1	2	3	4	5
A. Your own personal interest/benefits	1	2	3	4	99
B. For an interest you share together with other citizens/your community	1	2	3	4	99
C. To support family and friends	1	2	3	4	99
D. For a cause you believe in but does not relate to you personally	1	2	3	4	99

208. Cili nga aktivitetet e mëposhtme besoni se mund të kontribuojë në ndryshimin e gjendjes/situatës me të cilën jeni të pakënaqur në nivel vendor ose kombëtar? (QARKONI TË GJITHA ALTERNATIVAT E MUNDSHME)

- A. Votimi në zgjedhje (të dyja zgjedhjet - parlamentare/lokale)
- B. Tërheqja e vëmendjes së medias ndaj një problemi
- C. Angazhimi në parti politike
- D. Pjesëmarrja në aktivitete të organizuara nga qytetarët për të ushtruar presion mbi vendimmarrësit (p.sh. nënshkrimi i peticioneve, pjesëmarrja në debate publike, demonstrata ose protesta)
- E. Kontaktimi me deputetë/anëtarë të këshillave bashkiakë
- F. Pjesëmarrja në aktivitete të organizuara (p.sh. lidhja me OJF që merren me politikë/të drejtat e njeriut, nëpërmjet internetit/rrjeteve sociale, peticioneve në internet, fushatave në Facebook, Twitter, etj.

209. Cilin nga ndryshimet më poshtë do të donit të shikonit për të rritur pjesëmarrjen në zgjedhje në Shqipëri? PËRGJIGJU PËR SECILËN ALTERNATIVË

	Po	Jo	Nuk e di
A. Votimi i emigrantëve në vendbanimin e tyre aktual jashtë vendit			
B. Vota bosh (blank vote): mundësinë për të pasur abstenim / 'asnjë nga alternativat e mësipërme' në fletën e votimit			
C. Votimi përmes internetit			
D. Votimi që 16 vjeç			
E. Tjetër, ju lutem specifikojeni _____			

SEKSIONI 3 NJOHURITË DHE INTERESAT NË ANGAZHIMIN POLITIK

3. 1. Njohuritë

301. Po të mendoni për zgjedhjet e fundit të përgjithshme/parlamentare, a mund të thoni se cila parti mori shumicën në qarkun ku ju votuat/supozohej të votonit?

- PS PD LSI PR PDIU PBDNJ
 Asnjë Jo, s'mund ta them/nuk e di Tjetër _____

302. Po të mendoni për Kryetarin aktual të Bashkisë tuaj, a mund të thoni se cilës parti i përket ai/ajo?

- PS PD LSI PR PDIU PBDNJ
 Asnjë Jo, s'mund ta them/nuk e di Tjetër _____

303. Nga kush zgjidhet Presidenti i Republikës së Shqipërisë? (MOS LEXONI PËRGJIGJET)

- Drejtpërdrejtë nga qytetarët
 Nga Parlamenti
 Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)
 Nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD)
 Nuk e di
 Tjetër, ju lutem specifikojeni _____

304. Sa bashki ka aktualisht në vendi ynë? _____(numër)

305. Cili është Ministri aktual i Drejtësisë? (MOS LEXONI PËRGJIGJET)

- Fatmir Xhafaj
 Ylli Manjani
 Nasip Naco
 Edmond Haxhinasto
 Tjetër, ju lutem specifikojeni _____
 Nuk e di

306. Cili është Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë? (MOS LEXONI PËRGJIGJET)

- Ilir Meta
 Vangjel Dule
 Valentina Leskaj
 Jozefina Topalli
 Tjetër, ju lutem specifikojeni _____
 Nuk e di

3.2. Perceptim i njohurive personale

307. Në përgjithësi, sa mendoni se dini në lidhje me:

	Di shumë 1	Di mjaft- ueshëm	Di pak 3	Nuk di asgjë 4	Nuk mund të them me siguri 99
A. Politikën në Shqipëri	1	2	3	4	99
B. Qeverisjen vendore në Bashkinë/ qytetin tuaj	1	2	3	4	99
C. Qeverinë	1	2	3	4	99
D. Parlamentin	1	2	3	4	99
E. Rolin e Deputetëve	1	2	3	4	99
F. Rolin e Presidentit	1	2	3	4	99

4.3 Interesi

308. Sa të interesuar jeni për çështjet e mëposhtme?

	Shumë i/e interesuar 1	Mjaftu- eshëm i/e interesuar 2	Jo shumë i/e interesuar 3	Aspak i/e interesuar 4	Nuk e di 99
A. Politikën në Shqipëri	1	2	3	4	99
B. Qeverisjen vendore në Bashkinë/ qytetin tuaj	1	2	3	4	99
C. Qeverinë	1	2	3	4	99
D. Parlamentin	1	2	3	4	99
E. Rolin e Deputetëve	1	2	3	4	99
F. Rolin e Presidentit	1	2	3	4	99

309 . Cilat janë tre burimet kryesore nga të cilat informoheni mbi politikën në vend? (QARKONI VETËM TRE)

- A. Televizioni dhe Radio
- B. Shtypi i shkruar/gazetat
- C. Faqet në internet të televizioneve dhe shtypit të shkruar/gazetat
- D. Media të tjera në internet (Facebook, blogs, portale online dhe të tjera)
- E. Kanalet e informacionit të partive politike (deklaratat zyrtare të partisë dhe komunikimet jo-formale me persona të partisë)
- F. Miqtë dhe njohjet
- G. Të tjera _____
- H. Asnjë prej tyre
- I. Nuk e ndjek politikën fare

SEKSIONI 4. EFIKASITETI DHE KËNAQËSIA

Kënaqësia

401. Sa të kënaqur jeni me punën aktuale të:

	Plotësisht i/e kënaqur 1	Disi i/e kënaqur 2	As i/e kënaqur as i/e pakënaqur 3	Disi i/e pakënaqur 4	Tërësisht i/e pakënaqur 5	Nuk e di 99
A. Parlamentit	1	2	3	4		99
B. Qeverisë	1	2	3	4		99
C. Opozitës	1	2	3	4		99

Efikasiteti

402. Sa pushtet mendoni se keni ju personalisht për të ndikuar, mbi vendimmarrjen në:

	Shumë pushtet 1	Disi pushtet 2	Pak pushtet 3	Aspak pushtet 4	Nuk e di 99
A. Zonën tuaj lokale	1	2	3	4	99
B. Për vendin në tërësi	1	2	3	4	99

403. Would you call yourself a very strong, fairly strong, not very strong or not a supporter at all of any political party ?

- Po, shumë i/e fortë Po, mjaftueshëm i/e fortë
 Po, por jo shumë i/e fortë Nuk jam një mbështetës/e Nuk e di

Ju faleminderit!